

Annex 4: Program with six modules for the development of students' basic skills in professional education



PROGRAMI ME MODULE PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE BAZË TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PROFESIONAL

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. KONTEKSTI I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË LEXIM – SHKRIMIT, AFTËSIVE MATEMATIKORE DHE AFTËSIVE DIGJITALE NËPËRMJET ZBATIMIT TË AFTËSIVE PRAKTIKE.....	4
3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	7
4. MODULET.....	9
MODULI 1: PROFESIONI IM.....	9
1.1. Njohja me grupin	9
1.2. Njohja e profesionit tim.....	10
1.3. Llogaritja e një vakti ushqimor të shëndetshëm	12
1.4. Të ushqyerit e shëndetshëm	13
1.5. Veprimtari sportive.....	15
MODULI 2: GJUHA DHE KOMUNIKIMI.....	16
2.1. Opinioni dhe fakti	16
2.2. Aftësitë e lexim-shkrimit	19
2.3. Përdorimi i TIK.....	21
2.4. Shkrimi dhe dërgimi i një e-maili.....	22
2.5. Njësitë matëse matematikore	26
MODULI 3: MATEMATIKA, TIK-u DHE KOMUNIKIMI NË PROFESIONIN TIM.....	29
3.1. Atributet dhe aftësitë personale.....	29
3.2. Aftësitë digjitale në përpunimin e tekstit digjital	34
3.3. Aftësitë e komunikimit dhe lexim -shkrimit	35
3.4. Aftësitë matematikore.....	38
3.5. Jetë e shëndetshme	40
MODULI 4: Turizmi	44
4.1. Turizmi në Shqipëri dhe llojet e tij	44
4.2. Aftësitë e komunikimit	48
4.3. Aftësitë TIK.....	50
4.4. Zhvillimi i qëndrueshëm	51
4.5. Aftësitë matematikore	54
MODULI 5: Fatkeqësitë natyrore.....	57
5.1 Fatkeqësitë natyrore.....	57
<i>Disa nga llojet e katastrofave natyrore</i>	58
5.2 Aftësitë e komunikimit	59
.....	62
5.3. Aftësitë TIK.....	62

5.4. Aftësitë matematikore.....	62
5.5. Vullnetarizmi	63
MODULI 6: Arte	68
6.1. Arte	68
6.2. Aftësit e komunikimit	71
6.3. Aftësitë TIK	73
6.4. Aftësitë matematikore.....	74
6.5. Vendosja e një qëllimi.....	75

1. HYRJE

“Programi për zhvillimin e aftësive bazë të nxënësve nëpërmjet veprimtarive praktike” i konceptuar për nxënësit e klasës së X të arsimit profesional dhe i shtrirë në shtatë qytete të Shqipërisë është hartuar për një target nxënësish të shkollave të mesme profesionale me njohuri dhe shprehje të pamjaftueshme të shkruarit, të lexuarit, të matematikës, digjitale, dhe të aftësive të mendimit kritik, krijes dhe zgjidhjes së problemit, aftësi këto jetësore për funksionimin e tyre në jetë dhe në punë.

Programi u shërben mësuesve dhe trajnerëve të cilët do të përfshihen në zbatimin e tij për të pasuruar dhe përditësuar dijet dhe shprehjet e nxënësve, në përgjithësi dhe të atyre nga kategoritë në nevojë, në mënyrë të veçantë. Ky program specifik është konceptuar në formën e një udhëzuesi metodologjik nën koordinimin e UNICEF nëpërmjet Qendrës “Aftësi Konkurrese” e cila ka mbështetur nisma të ndryshme në këtë fushë.

“Programi për zhvillimin e aftësive të leximit – shkrimit, aftësive matematikore dhe aftësive digjitale nëpërmjet zbatimit të aftësive praktike” synon zhvillimin e individëve dhe të nxënësve nga shtresa të marginalizuara, duke mbështetur dhe përmbushur një nga prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, gjithpërfshirjen. Fokusi në këtë program është vendosur në metodologjinë e mësimdhënies, për të lehtësuar procesin e të nxënësve për të gjithë nxënësit që kanë vështirësi në përvetësimin e aftësive bazë akademike dhe aftësive jetësore, riaftësimin dhe integrimin e tyre në shkollë dhe në tregun e punës.

Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje është përmirësimi social dhe ekonomik i komuniteteve në vështirësi në të gjithë Shqipërinë. Ky program do t’u krijojë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre bazë akademike, të njohin më mirë komunitetin dhe tregun e punës si edhe vlerat e nevojshme për integrimin social dhe zhvillimin ekonomik.

“Programi për zhvillimin e aftësive të leximit – shkrimit, aftësive matematikore dhe aftësive digjitale nëpërmjet zbatimit të aftësive praktike” do të zbatohet me nxënësit e shkollave profesionale që janë në klasë të X, përfshirë nxënësit që vijnë nga shtresat e marginalizuara. Ai do të zbatohet në shtatë njësi arsimore vendore konkretisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Fier, dhe Korçë me një kohëzgjatje prej 12 ditësh.

Ky program praktik mund të shërbejë për të shtrirë edhe në shkollat e qyteteve të tjera të vendit, pasi është lehtësisht i përshtatshëm për grupet në vështirësi në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Programi është një koncept i ri në Shqipëri për këtë kategori të nxënësve. Synimi i këtij programi është t’u ofrojë mësimdhënësve apo specialistëve të përfshirë në këtë proces, një

instrument për mësimdhënien dhe të nxënin e suksesshëm në fushat e të shkruarit, të lexuarit, të matematikës, digjitale, të sportit dhe të orientimit profesional në karrierë.

2. KONTEKSTI I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË LEXIM – SHKRIMIT, AFTËSIVE MATEMATIKORE DHE AFTËSIVE DIGJITALE NËPËRMJET ZBATIMIT TË AFTËSIVE PRAKTIKE

“Programi për zhvillimin e aftësive të lexim – shkrimit, aftësive matematikore dhe aftësive digjitale nëpërmjet zbatimit të aftësive praktike” ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit dhe komunikimit gjuhësor, matematik dhe digjital, me idetë bazë dhe strukturat gjuhësore, matematikore, digjitale si dhe t’u zhvillojë atyre aftësitë komunikuese dhe të zgjidhjes së situatave në jetën praktike të përditshme.

Këto aftësi nëpërmjet matematikës, gjuhës, TIK-ut, dhe lëndëve të tjera e përgatisin individin për rolin e tij të ardhshme në shoqëri, mundësojnë zhvillimin e aftësive të komunikimit, aftësive matematikore, aftësive digjitale, aftësive të arsyetimit e logjikës, aftësive për të menduar në mënyrë kritike dhe për të hulumtuar, aftësive qytetare dhe aftësive personale duke nxitur kërshërinë dhe inkurajimin si dhe vetëbesimin për zgjidhjen e situatave konkrete në jetën e përditshme.

Një nga aspektet më të rëndësishme në kurrikul është zhvillimi i kompetencave kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës të cila nxisin zhvillimin e aftësive bazë dhe ndihmojnë individin të kuptojë përdorimin e gjuhës, TIK-ut dhe matematikës në mënyrë efektive që të bëhen qytetarë aktivë dhe kritikë në shoqëri. Njohuritë bëhen kuptimplota dhe të fuqishme, nëse marrin jetë në kurrikul dhe zbatohen në situata praktike. Zhvillimi, ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe i aftësive bazë gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të përzgjedhë situatat e të nxënit, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme për procesin e të nxënit. Kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës të cilat nxisin dhe ndihmojnë në zhvillimin e aftësive bazë të nxënësve përcaktohen si më poshtë:

Kompetencat gjuhësore

-  Nxënësi përdorin diskutimin dhe ndërveprojnë me të tjerët, me qëllim që të komunikojnë, të mësojnë të shprehin qartë dhe të argumentojnë mendimet dhe idetë e tyre.
-  Nxënësi zotërojnë “artin” e të folurit dhe të dëgjuarit, bëjnë prezantime formale dhe marrin pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tyre.

- ✚ Nxënësi lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej 3- 5 paragrafësh, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit dhe stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve.
- ✚ Nxënësi krijon marrëdhënie të qëndrueshme me leximin, nëpërmjet të cilit fitojnë kënaqësi dhe informacion.
- ✚ Nxënësi zbaton njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t'u bërë lexues të pavarur, si dhe për të kuptuar dhe për të gjykuar tekste të llojeve të ndryshme.
- ✚ Nxënësi kupton tekste të llojeve të ndryshme.
- ✚ Nxënësi identifikon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme.
- ✚ Nxënësi shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me 3-5 paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve.
- ✚ Nxënësi shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të një eseje.
- ✚ Nxënësi pasuron fjalorin e tij, fiton njohuri gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit, si dhe zbaton rregullat e gjuhës së folur dhe të shkruar.
- ✚ Nxënësi përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja.

Kompetencat matematikore

- ✚ Nxënësi përdor numrat, veprimet me to, matjet, konceptet gjeometrike, shprehjet algjebrike, grafikët, interpretimin e problemave, identifikimin e të panjohurave, zgjidhjen e ekuacioneve, diagramet, grafikët, simbolet etj., për zgjidhjen e situatave problemore.
- ✚ Nxënësi përdor komunikimin me forma të ndryshme për përkthimet me simbole, rezultatet e zgjidhjes së problemave, për interpretimin e vetive të figurave e trupave, për interpretimin e të dhënave, tabelave, diagrameve, për diskutimet e ekuacioneve etj.
- ✚ Nxënësi përdor lidhjet konceptuale të numrave me ekuacionet, shprehjet algjebrike, problemave algjebrike dhe gjeometrike, drejtëzave dhe planeve, matjeve, tabelave të statistikës dhe probabilitetit etj.
- ✚ Nxënësi përdor arsyetimin dhe argumentet për veprimet me numrat, fuqitë, rrënjët, funksionet trigonometrike, karakteristikat e planit dhe të hapësirës, shndërrimet gjeometrike, formulat gjeometrike për interpretimin dhe formulimin e konkluzioneve etj.
- ✚ Nxënësi modelon me anë të numrave, të simboleve, të shndërrimeve gjeometrike dhe të tabelave. Ai formulon ligjësi, formulon problema nga situata reale, ndërton e përdor formula, njehson syprina etj.

- ✚ Nxënësi përdor TIK për të ndërtuar tabela dhe grafikë, për prezantime, hulumtime, përpunime dhënash etj.

Kompetencat TIK

- ✚ Nxënësi zbulon dhe vlerëson ndikimin e teknologjisë në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedis, në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen.
- ✚ Nxënësi përzgjedh informacione nga burime të ndryshme në përshtatje me qëllimin që ka;
- ✚ Nxënësi paraqet informacione, duke shfrytëzuar larmi programesh, teknologjish informacioni dhe komunikimi (p.sh., PowerPoint, Word, Excel, video klipe, aparat fotografik, digjital).
- ✚ Nxënësi përdor teknika dhe strategji të formave të ndryshme, me qëllim përfitimin, analizën, përpunimin, dhe interpretimin e informacioneve.
- ✚ Nxënësi vlerëson seriozitetin dhe besueshmërinë e burimeve, duke përdorur kritere, si: autorësia, lidhja, aktualiteti, përvoja e autorit.
- ✚ Nxënësi integron njohuri dhe shkathtësi/shprehi për gjetjen e zgjidhjeve për probleme të thjeshta teknologjike.
- ✚ Nxënësi vlerëson dhe zbaton në praktikë njohuritë e nevojshme për çështjet e shëndetit dhe të sigurisë.
- ✚ Nxënësi përdor programet kryesore kompjuterike në shërbim të të nxënit.
- ✚ Nxënësi punon me një komunitet online për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor.
- ✚ Nxënësi pajisen me grupe të ndryshme aftësish që lidhen me veprimtari e profesione të ndryshme.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

“Programi për zhvillimin e aftësive të lexim – shkrimit, aftësive matematikore dhe aftësive digjitale nëpërmjet zbatimit të aftësive praktike” përmban 6 module. Çdo modul ka 5 njësi mësimore dhe çdo njësi mësimore përfshin 2-3 veprimtari të cilat nxisin në formë të integruar zhvillimin e aftësive të lexim – shkrimit, aftësitë matematikore, aftësitë e mendimit kritik, aftësitë e zgjidhjes së problemit dhe aftësive digjitale. Theksojmë që këto module vijnë të integruara për të zhvilluar dhe një sërë aftësish të tjera si: aftësitë e gjelbra – mjedisore, aftësitë artistike, aftësitë personale dhe qytetare. Një modul për shkak të veprimtarive të shumta që përmban një njësi mësimore është planifikuar të zhvillohet i ndarë në dy ose tre ditë sipas planifikimit të bërë nga mësuesi. Veprimtaritë praktike që përfshin çdo njësi mësimore janë të vlefshme, por mbi të gjitha shumë argëtuese për nxënësit, nëpërmjet të cilave ata mësojnë edhe argëtohen.

Modulet janë si më poshtë:

1. Profesioni im
2. Gjuha dhe komunikimi
3. Matematika, TIK-u dhe komunikimi në profesionin tim
4. Turizmi
5. Fatkeqësitë natyrore
6. Arte

Gjatë zbatimit të këtij programi nxënësi:

- zhvillon bazat e të menduarit dhe komunikimit gjuhësor, matematik dhe digjital;
- kupton koncepte gjuhësore dhe matematike;
- komunikon dhe zbavitet nëpërmjet situatave reale;
- demonstroi të kuptuarit e informacionit të tekstit;
- mëson të argumentojë, me shkrim dhe me gojë, përgjigjet e tij duke u bazuar në ilustrime dhe mjete konkrete;
- dallon faktin nga opinioni;
- praktikohet në vëzhgime të situatave që kanë lidhje me mjedisin e tyre të përditshëm;
- zbulon ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet shkak - pasojë ndërmjet dukurive;

- analizon elementet kryesore të gjuhës;
- vlerëson informacionet e tekstit, duke dhënë argumente;
- shkruan një tekst të shkurtër në varësi të qëllimit që ka;
- zbaton rregullat kryesore drejtshkimore gjatë të shkruarit;
- përforcon veprimet bazë me numra dhe konceptin e numrit;
- argumenton veprimet dhe përfundimet e tyre dhe ia paraqet të tjerëve;
- përdor rregulla dhe ndjek udhëzime;
- edukohet të punojë në grup;
- paraqet situata në mënyra të ndryshme;
- ndihet i suksesshëm;
- bashkëpunon në mënyrë aktive me moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, gender, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët;
- shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët;
- organizon, mbledh dhe shfaq të dhënat e gjetura nga burimet e informacionit elektronik.

Është e rëndësishme të theksojmë se renditja dhe veprimtaritë praktike që janë parashikuar në këtë program janë shumë fleksibël pasi mësuesit mund të zhvillojnë edhe tema e veprimtari të tjera në përmbushje të këtij programi, sipas interesave dhe nevojave të nxënësve brenda apo jashtë mjedisit të klasës.

4. MODULET

MODULI 1: PROFESIONI IM

Nr.	Njohuritë dhe aftësitë për modulin
1.1	Njohja me grupin
1.2	Njohja e profesionit tim
1.3	Llogaritja e një vakti ushqimor të shëndetshëm
1.4	Të ushqyerit e shëndetshëm
1.5	Veprimtari sportive

Nëpërmjet veprimtarive praktike të paraqitura në modulin “Profesioni im” nxënësi ndërton në mënyrë të integruar aftësitë bazë të të folurit, të shkruarit, të lexuarit, të matematikës, digjitale, të menduarit, të aftësive personale, qytetare, të orientimit për karrierë dhe të aftësive fizike.

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- ✓ ndërvepron me të tjerët, me qëllim që të komunikojë, të mësojë të shprehë qartë dhe të argumentojë mendimet dhe idetë e tij;
- ✓ bën prezantime formale dhe merr pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tij;
- ✓ vlerëson profesionin e përzgjedhur;
- ✓ kryen llogaritje matematikore për zgjidhjen e situatave konkrete;
- ✓ liston vlerat që ka për të ushqimi, higjiena, lojërat etj;
- ✓ bën dallimin ndërmjet ushqimit të shëndetshëm dhe jo të shëndetshëm;
- ✓ zhvillon aftësitë e komunikimit ndërpersonal dhe në grup;
- ✓ ndërvepron pozitivisht dhe në mënyrë efektive me të tjerët;
- ✓ zhvillon aftësitë fizike nëpërmjet aktiviteteve sportive.

Mësuesi gjatë çdo prezantimi nga nxënësit bën kujdes që ata të zbatojnë rregullat gramatikore, gjuhësore duke i shkruar dhe duke i komunikuar me fjali të plota në mënyrë të qartë dhe të saktë.

1.1. Njohja me grupin

Veprimtaria 1: Prezantoj veten

Prezantohuni para grupit. Mësuesi fton secilin nxënësi të prezantojë veten përpara grupit sipas rubrikave të vendosura në tabelën 1.

Tabela 1. Prezantoj veten

Unë quhem	
Unë jetoj me:	
Unë jam në shkollën:	
Shokët e mi janë:	
Mua më pëlqen:	
Profesioni që unë kam zgjedhur:	
Unë dua të punoj si:	

Veprimtaria 2: Prezantoni shokun/shoqen tuaj

Mësuesi fton nxënësit të prezantojnë shokun/shoqen e tyre sipas rubrikave të vendosura në tabelën 2. Për këtë veprimtari ai kërkon nga nxënësit t'i kthehen shokut/shoqes në të majtë ose të djathtë të tyre dhe të flasin me të për disa minuta, në mënyrë që të jenë në gjendje ta prezantojnë shokun/shoqen e tyre para grupit (*nxënësit janë të lirë të lëvizin*). Prezantimi i shkruar duhet të përfshijë: Emri im është..., mosha..., kafsha e preferuar....., ngjyra e preferuar....., filmi i preferuar....., ushqimi i preferuar....., veprimtaria e preferuar....., një fakt interesant. Mësuesi mbledh nxënësit dhe fton çiftet e nxënësve të prezantojnë njëri - tjetrin para tërë grupit.

Tabela 2. Prezantoj shokun/shoqen time	
Emri:	
Mosha:	
Kafsha e preferuar:	
Ngjyra e preferuar	
Filmi i preferuar	
Ushqimi i preferuar	
Veprimtaria e preferuar	
Një fakt interesant	

1.2. Njohja e profesionit tim

Informacion

Profesionet dhe mjetet e punës kanë ndryshuar shumë që nga lashtësia. Disa profesione dhe mjete pune janë zhdukur fare, disa janë modernizuar dhe disa të tjera sapo janë krijuar. Shoqëria i ka në kujtesën e saj historike, në libra dhe në muze profesionet dhe mjetet e vjetra të punës. Po të lexojmë librat e vjetër dhe të studiojmë historinë e kohës së hershme do të mësojmë se kudo në botë kishte mjekë dhe arkitektë, strategë të ushtrisë dhe ndërtues kështjellash apo piramidash. Shkrimtarë, piktorë, instrumentistë, mendimtarë dhe filozofë zbukurorin jetën e shoqërive ku ata bënin pjesë, por edhe të fasadave të ndërtimeve, bukuritë e të cilave vizitojmë

ne sot. (Mësuesi mund të prezantojë foto të hershme të qytetit duke e krahasuar me panoramën e qytetit sot.)

Sot, ndërtesat shumëkatëshe, urat, hekurudhat, aeroportet projektohen në kompjuter. Po kështu analizat mjekësore bëhen nga aparatura të specializuara, të cilat japin saktë rezultatet e tyre. Në shumë sektorë, kompjuteri është bërë mjet i domosdoshëm. Agjencitë e udhëtimit, ato turistike, bankat, zyrat e sigurimeve, institucionet e ndryshme i bëjnë veprimet e tyre nëpërmjet programeve në kompjuter.

Profesionet sot janë shtuar, sidomos në sektorin e shërbimeve për qytetarët. Për t'u bërë një profesionist i mirë të duhet të ndjekësh një shkollë profesionale, studime të mëtejshme, por më e rëndësishmja është që të mësosh gjatë gjithë jetës. (Mësuesi mund të paraqesë foto të përdorimit të TIK në profesione të ndryshme.)

Veprimtaria 1: Ju përgjigjemi pyetjeve

Mësuesi fton nxënësit të mendojnë dhe më pas të diskutojnë përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme:

- Pse themi se profesioni i ndërtuesit është shumë i vjetër? Argumento.
- Cilët janë njerëzit më të njohur në qytetin tuaj? Çfarë profesioni kryejnë ata?
- Cili është profesioni më i kërkuar në qytetin tuaj për momentin dhe pse?
- Bëj një listë të profesioneve që kanë familjarët ose të afërmit e tu.

Veprimtaria 2: Varka e shpëtimit

Mësuesi ju prezanton nxënësve situatën e mëposhtme.

Hamendësojmë se bota është përmbytur. Pas përmbytjes së botës i kërkohet Noes të shpëtojë njerëz me profesione të ndryshme. Ai ka mundësi të marrë në varkën e tij vetëm 6 njerëz.

- Sipas mendimit tuaj cilët do të jenë ato profesione të vlefshme për shoqërinë që do të shpëtojë Noe?

Mësuesi fton nxënësit të ndahen në grupe dhe të vendosin së bashku se cilat prej profesioneve janë më të vlefshme për shoqërinë e sotme, duke mos lejuar të hipin në varkën e shpëtimit profesionet më pak të vlefshme. Në fund secili grup nëpërmjet një kryetari raporton për profesionet e mbijetuara.

Lista e profesioneve			
Kapiteni	Programues i kompjuterëve	Animatori social	Tapicieri
Hidrauliku	Marangozi	Stilisti	Menaxher
Mekaniku	Shitësi	Agronomi	Punonjës pastrim

Elektrici	Veterineri	Receptionisti	Muratori
Kuzhinieri	Gjeologu	Teknologu ushqimor	Punonjësi i ndërtimit
Kontabilisti	Guiduesi turistik	Punonjësi i pyjeve	Minatori

Shkruani arsyet pse duhen shpëtuar këta 6 njerëz.

Emërtimi i profesionit të shpëtuar: _____

Arsyet e përfshirjes në varkë të këtij profesioni: _____

Veprimtaria 3: A kam zgjedhur unë profesionin e duhur

Mësuesi fton nxënësit të plotësojnë fletën e punës më poshtë:

Unë kam zgjedhur të ndjek shkollën profesionale _____

Vendos + nëse i ke kryer veprimtaritë e mëposhtme:

Veprimtaria	Po	Jo
Kam kontrolluar nëse zgjedhja ime përputhet me interesat, aftësitë dhe cilësitë e mia		
Kam marrë informacionin e domosdoshëm rreth shkollës dhe kualifikimit profesional që kam zgjedhur		
Kam biseduar/këshilluar me prindërit/të afërmit e mi		

Shkruaj të paktën tri arsye pse kjo alternativë është e mirë për ty:

1. _____
2. _____
3. _____

1.3. Llogaritja e një vakti ushqimor të shëndetshëm

Veprimtaria 1

Mësuesi prezanton situatën e mëposhtme dhe fton nxënësit të diskutojnë rreth saj.

Shkencëtarët që merren me problemet e të ushqyerit rekomandojnë për një mëngjes të ekuilibruar (të shëndetshëm):

12 – 15% proteina;

më pak se 35% yndyrna;

më tepër se 50% sheqerna.

Majlinda ka ngrënë në mëngjes ëmbëlsira me drithëra, përbërja e të cilave tregohet më poshtë:

30% proteina;

40% yndyrna;

60% sheqerna.

- Si mendoni a ka ngrënë ajo një mëngjes të shëndetshëm?
- Krahasoni sa më shumë apo më pak nga vlerat ushqimore të rekomanduara ka marrë Albana?
- Si do të vepronit ju?

Veprimtaria 2

Ekipet e alpinistëve, kur dalin për stërvitje, qëndrojnë disa ditë në zonat malore. Zakonisht me vete ato marrin ushqime të thata, por disa kanë dëshirë të gatujnë vetë. Një herë 6 alpinistë të rinj kishin marrë me vete vezë, sepse i pëlqenin shumë vezët e fërguara. Gjatë udhëtimit një pjesë e vezëve të secilit ishin thyer. Të gjashtë shokët u morën vesh dhe vezët e pathyera i ndanë në mënyrë të barabartë. Pasi hëngrën në mëngjesin e ditës së parë dhe të dytë secili nga 2 vezë të fërguara, të gjashtë alpinistëve së bashku u mbetën sa trefishi i vezëve që mori çdonjëri prej tyre kur i ndanë vezët në mënyrë të barabartë.

- Si mendoni ju sa vezë u kishin mbetur të pathyera gjithsej alpinistëve?


1.4. Të ushqyerit e shëndetshëm


Veprimtaria 1

Veprimtaria fillon me një bisedë me nxënësit për nevojën e ngrënies së ushqimit të shumëllojshëm dhe në sasi të mjaftueshme për zhvillim të rregullt dhe të shëndetshëm. Më pas mësuesi u shpërndan nxënësve *Fletën e punës “Pjata ime e ushqimeve”*. Nxënësit ushtrohen në punë të pavarur për të zgjedhur dhe vizatuar ushqimin e tyre të shëndetshëm duke u bazuar në figurat ose përvojën e tyre. Pas përfundimit nxënësit i ngjitin punët e tyre në tabelë dhe diskutojnë se cila pjatë përmban ushqimin më të shëndetshëm.

Fletë punë: Pjata ime e ushqimeve

Vizatoni brenda në pjatë ushqimet tuaja të preferuara të shëndetshëm duke u bazuar në figurat e mëposhtme ose në përvojën tuaj.





Veprimtaria 2: Kuiz - Jeto shëndetshëm

Kuiz-i mund të zhvillohet në formën e një loje, ku nxënësit ndahen në skuadra, i përgjigjen pyetjeve dhe diskutojnë rreth tyre duke sjellë shembuj nga jeta e tyre personale.

		E saktë	E gabuar
1.	Mënyra e shëndetshme e të ushqyerit nuk është e rëndësishme për jetën e njeriut.		
2.	Që të jesh i shëndetshëm, duhet të ushqehesh me ushqim të shumëllojshëm.		
3.	Ushqimi duhet të konsumohet përmes disa vakteve të caktuara.		
4.	Ngrënia e tepërt është shumë e dëmshme për shëndetin.		
5.	Të luash me kompjuter është më mirë se sa të luash futboll.		
6.	Në higjienën personale përfshihet vetëm bërja e dushit.		
7.	Gjumi nevojitet për pushimin e njeriut.		

Përgjigje:

1. E gabuar; 2. E saktë; 3. E saktë; 4. E saktë; 5. E gabuar; 6. E gabuar; 7. E saktë.

Veprimtaria 3: Një mëngjes i pasur me vlera ushqimore

Matematika mund të jetë e dobishme kur ne planifikojmë ushqimin javor. Në këtë situatë, ne duhet të planifikojmë ushqim me vlerë për shtatë ditë në javë.

Situata:

Planifikoni një ushqim me vlerë për 7 ditë në javë. Përfshini në planin tuaj detaje duke treguar numrin e njerëzve që do të hanë, menynë dhe çmimin. Planifikojeni këtë për familjen tuaj (ose

nëse dëshironi, ju mund ta planifikoni atë për një familje të përbërë d.m.th. duke përfshirë dhe njerëz të tjerë të afërm tuaj). Disa nga pyetjet ose detajet për planin tuaj mund të jenë:

- Sa njerëz jeni në familjen tuaj? Çfarë pëlqejnë ata të hanë? Çfarë pëlqejnë të pinë? Sa shumë hanë dhe pinë ata?
- Si mund të planifikoj unë një ushqim të balancuar çdo ditë? Çfarë ushqimesh përmbushin nevojat e të rriturve dhe fëmijëve?
- Vendosni disa çmime për mallrat që do të blini? Shikoni çmimet e dyqaneve dyqaneve ose vizitoni një market për të parë çmimet e menysë suaj javore.
- Në qoftë se ju planifikoni të përdorni ushqime ose pjesë përbërëse të tyre nga ushqimet që keni aktualisht në shtëpinë tuaj, llogarisni sa do t'ju kushtojnë për të shtuar më shumë.
- Në qoftë se ju planifikoni të hani jashtë një darkë, cilat do të ishin vlerat ushqimore dhe çmimi i ushqimit tuaj?
- Sa kalori, sa proteina etj., duhet të merrni gjatë një vakti ushqimor?
- Si do ta paraqisni menynë e javës suaj, vlerat ushqimore dhe çmimin e saj? A do të përdorni ju tabela apo grafikë të tregoni ndonjë nga informacionet?

Pyetje të tjera

- Krahasoni menynë tuaj me meny të tjera të bëra nga shokët e klasës.
- Si janë po të krahasojmë vlerat dhe çmimin e ushqimeve?
- Do të dëshironit të bënit ndonjë ndryshim në menynë tuaj?
- Vlerësoni menynë e shokëve tuaj. Si ju duket?

1.5. Veprimtari sportive

Mësuesi organizon me nxënësit lojëra të ndryshme sipas preferencave të tyre (lojë me top, tërheqje litari, lojë me thasë).

MODULI 2: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Nr.	Njohuritë dhe aftësitë për modulin
2.1	Opinionit dhe faktit
2.2	Aftësitë e lexim-shkrimit
2.3	Përdorimi i TIK
2.4	Shkrimi dhe dërgimi i një e-maili
2.5	Njësitë matëse matematikore

Nëpërmjet veprimtarive praktike të paraqitura në modulin “Gjuha dhe komunikimi” nxënësi ndërton në mënyrë të integruar aftësitë bazë të të folurit, të shkruarit, të lexuarit, të matematikës, digjitale, aftësitë e të menduarit kritik, aftësitë e zgjidhjes së problemit, aftësitë personale, qytetare, etj.

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- ✓ bën dallimin midis opinionit dhe faktit;
- ✓ mbështet pohimin e tij në fakte/dëshmi;
- ✓ analizon dhe vlerëson fakte në media dhe në tekstin informativ;
- ✓ demonstroi të kuptuarit e informacionit të tekstit;
- ✓ identifikon qëllimin e autorit;
- ✓ lidh idetë kryesore të tekstit me përvojat dhe njohuritë e tij;
- ✓ shkruan një tekst të shkurtër në varësi të qëllimit që ka;
- ✓ zbaton rregullat kryesore drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- ✓ shkruan dhe dërgon një e-mail;
- ✓ merr pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tij;
- ✓ kryen veprime matematikore për njehsimin e masave;
- ✓ ndërvepron pozitivisht dhe në mënyrë efektive me të tjerët.

2.1. Opinionit dhe faktit

Informacion


Faktet janë të dhëna mbi të cilat dikush mund ta bazojë gjykimin ose vendimin e tij. Mbledhja dhe vlerësimi i fakteve janë aftësi të rëndësishme. Zakonisht bëhen dy gabime. E para, njerëzit nganjëherë japin pikëpamjet dhe marrin vendimet e tyre pa pasur fakte ose i bazojnë ato në fakte të gabuara. E dyta, ka një tendencë për të mos i marrë parasysh faktet që janë në kundërshtim me pikëpamjet tona të mëparshme.

Në vijim, nxënësi mëson të bëjë dallimin ndërmjet opinionit dhe faktit.

Veprimtaria 1

Filloni me një veprimtari e cila do t'i ndihmojë nxënësit të bëjnë dallimin mes një opinionit dhe një fakti. Ndani nxënësit në çifte. Kërkoni nga çdo nxënës të shkruajë në një flete A4, tri opinione dhe tri fakte për veten e tij, pa ndonjë renditje të veçantë. Më pas ata shkëmbejnë fletën me shokun që janë në çift. Shkëmbejnë shënimet me partnerin dhe ju kërkojnë atyre të shënojnë përbri secilës fjali apo pohim gërmën F për Fakte dhe gërmën O për Opinione. Në fund mësuesi dhe nxënësit dëgjojnë, kontrollojnë dhe diskutojnë saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Më pas mësuesi orienton nxënësit për të kuptuar saktë dallimin midis faktit dhe opinionit.



Informacion

- ✚ Fakti në përgjithësi i referohet një diçkaje që është e vërtetë dhe që mund të verifikohet si e tillë. Pra, një fakt është diçka që mund të provohet se është e vërtetë.
- ✚ Opinioni i referohet një bindjeje personale. Lidhet me atë se si dikush ndihet për diçka. Të tjerët mund të pajtohen ose jo me një opinion, por ata nuk mund ta vërtetojnë ose përgënjeshtrojnë atë.



Aftësia për ta bërë dallimin në mes faktit dhe opinionit i ndihmon nxënësit të zhvillojnë shkathtësitë e tyre kritike analitike dhe komunikuese. Është e rëndësishme që nxënësit gjithashtu të kuptojnë se gjërat jo gjithmonë janë ashtu siç duken. Nganjëherë, gazetarët, bizneset, qëllimisht ose jo, e paraqesin opinionin si fakt dhe anasjelltas. Prandaj është e rëndësishme që nxënësit të kuptojnë qartë se çka përbën fakt dhe opinion, dhe të praktikojnë dallimin në mes tyre.

Veprimtaria 2: Gjurmuesi i fakteve



Mësuesi ndan klasën në tre grupe. Secilit grup jepini një gazetë. Kërkojini nxënësve të nënvizojnë vetëm faktet për një artikull sportiv, social apo ekonomik të një gazete. Më pas diskutojini ato në klasë.

Veprimtaria 3: Cili është opinionin tuaj?

Mësuesi ju kërkon nxënësve të lexojnë



me zë pyetjet mëposhtme:

- A duhet të ndalohen telefonat celularë në shkollë?
- A kanë nevojë fëmijët për detyra shtëpie?
- A e përmirëson teknologjia jetën tonë?

Mësuesi ndan nxënësit në tre grupe dhe secilit grup i jep një pyetje nga tabela e mëposhtme. Secili grup plotëson tabelën e mëposhtme për pyetjen përkatëse.

Pyetja	Po	Jo	Pse? Jepni dy deri në tre arsye për opinionin tuaj.
A duhet të ndalohen telefonat celularë në shkollë?			
A kanë nevojë fëmijët për detyra shtëpie?			
A e përmirëson teknologjia jetën tonë?			

Lexoni nga një pyetje me radhë dhe lini nxënësit të diskutojnë shkurtimisht për opinionin e tyre dhe arsyet e dhëna. Kontrolloni diskutimin, por mos ndërhyri. Nëse është e nevojshme, përdorni parafrazimin ose pyetjet sqaruese: Ajo që po thoni është... A e kuptova mirë se ju thatë se...? Diskutoni procesin me një nxënës. Si e formulojmë opinionin tonë? Bazuar në çfarë? Çfarë mund të na shtyjë të ndryshojmë mendim?

2.2. Aftësitë e lexim-shkrimit

Teksti: Si të gesh punë në sezonin e verës?

Për të pasur rezultate sa më të mira duhet të jeni aktivë. Filloni planifikoni kërkimin e një pune për sezonin e verës, kohë më përpara. Gjeni se kur fillojnë kompanitë të marrin kërkesat për punë në sezonin e verës. Në shumë kompani kjo ndodh deri në 6 muaj para verës. Lidhur drejtpërsëdrejti me kompanitë, për të cilat jeni të interesuar, duke telefonuar personin që merret me menaxhimin e personelit.

Mos u dorëzoni nëse nuk keni sukses herën e parë. Përgatituni të lidheni me një numër punonjësish. Gjetja e punës së parë për verën, në mënyrë të veçantë, mund të kërkojë dhjetëra kërkesa, telefonata dhe intervista. Këmbëngulja sjell rezultate.

Informacioni për punët në sezonin e verës gjendet në gazeta ose në faqe interneti, dhe mund të gjenden këshilla në faqet e kompanive në internet. Kontrolloni këndet e njoftimeve me kujdes, pasi edhe ofertat për punë në sezonin e verës afishohen gjithashtu atje. Mund të pyesni edhe shokët tuaj për përvojat që kanë pasur në gjetjen e një pune për sezonin e verës.

Kontrolloni me kujdes mundësitë në zonën ku jetoni. Mendoni për kompani në zonën tuaj, që mund të punësojnë personel të përkohshëm, me qëllim që ata të vazhdojnë punën gjatë verës. Kërkoni numërorin telefonik dhe kërkoni këshilla nga zyra lokale e biznesit dhe e industrisë. Mos u përqendroni vetëm në kompanitë e mëdha- çdokush kërkon të gjejë punë në to, kështu që kërkoni edhe në kompanitë e vogla. Ato mund të kenë punë interesante për sezonin e verës. Kërkoni në mënyrë krijuese për variante të ndryshme. Pyesni këdo që njihni e që mund t'ju ndihmojë.

Përdorni lidhjet e vjetra. Nëse keni pasur më parë një punë në sezonin e verës, lidhuni në kohën e përshtatshme me kompaninë për të cilën keni punuar dhe kërkoni që të punoni atje përsëri. Do të keni përparësi, pasi e njihni mënyrën se si punohet aty, kërkesat për punën dhe njerëzit që punojnë atje.

Mos harroni!

Punët në sezonin e verës ju ndihmojnë për të fituar përvojë. Shumë të rinjve u pëlqen të punojnë në verë për të fituar përvojë pune dhe për të fituar para për vete. Atyre u pëlqen të krijojnë një ide për punën duke parë, duke bërë dhe duke pasur përvoja personale. Shumë punëtorë sezonalë që gjejnë punë rastësisht, kanë treguar interes në këtë fushë, por edhe më vonë, pasi përfundojnë shkollën, ata kanë gjetur punë në një kompani që njohin. Për punëdhënësin, punësimi i një të riu gjatë sezonit veror nuk është sakrificë, po një investim në të ardhmen.

Veprimtaria 1: A e kam kuptuar mirë tekstin që lexova?

Pasi e kanë lexuar tekstin në kompjuter (*nëse është e mundur*), mësuesi ndan nxënësit në çifte. Secilit çift i jepet fletën e punës më poshtë. Pasi e kanë plotësuar nxënësit prezantojnë përgjigjet e tyre. Fleta e punës krijon mundësi që nxënësit të demonstrojnë nëse e kanë kuptuar ose jo tekstin. Mësuesi nxit përgjigjet e nxënësve, duke i pyetur: *Pse? Ku duket kjo në tekst? Po ju të tjerët si mendoni etj. Sa përgjigje të sakta kishit ju?*

Fletë pune

Lexoni pohimet në tabelë dhe shënoni nëse janë të vërteta (V) ose të gabuara (G).

Nr.	Pohimi	V/G
1.	Duhet t'i përqendroni kërkimet tuaja për punë gjatë sezonit të verës vetëm në kompanitë e mëdha.	
2.	Të kërkosht punë përsëri në kompaninë për të cilën keni punuar dikur, është një mundësi e mirë.	
3.	Mund të filloni kërkimin e një pune për sezonin e verës, rreth 6 muaj më përpara.	
4.	Për punëdhënësin, punësimi i një të riu gjatë sezonit veror është nuk është ide e mirë, pasi duhet të investojë kohë për t'i mësuat rregullat e punës.	
5.	Kompanitë e vogla mund të kenë punë interesante për sezonin e verës.	
6.	Gjetja e punës së parë për verën, në mënyrë të veçantë, mund të kërkojë dhjetëra kërkesa, telefonata dhe intervista.	
7.	Informacionin për punë gjatë sezonit të verës mund ta gjeni vetëm në internet.	
8.	Një punë sezonale është një mundësi e mirë për të rinjtë që të kuptojnë interesat e tyre për punën dhe pasi të përfundojnë shkollën, të dinë ku dhe çfarë pune të kërkojnë.	
9.	Gjetja e një pune gjatë verës nuk kërkon kohë dhe shumë kërkime nga të rinjtë.	
10.	Të rinjve u pëlqen të punojnë në verë për të fituar përvojë pune dhe për të fituar para për vete.	

Veprimtaria 2: Rendit sipas radhës

Teksti është i përbërë nga 6 paragrafë, të cilët mësuesi i ka prerë me gërshërë. Ai i ndan nxënësit në grupe dhe çdo grupi i jep 6 fishat (paragrafët). Nxënësit duhet t'i renditin paragrafët sipas radhës (siç shihet në figurë). Gjithashtu, ata duhet të argumentojnë renditjen e tyre. P.sh., në fillim është paragrafi: *Për të pasur rezultate sa më të mira duhet të jeni aktivë...*, sepse çdo veprimtari nis me planifikimin; në fund është paragrafi: *Mos harroni!...*, pasi një kujtesë e rëndësishme (si konkluzion i përgjithshëm) për lexuesit etj.

Veprimtaria 3: Diskutojmë së bashku

Mësuesi drejton disa pyetje për nxënësit:

- Cili është qëllimi i këtij teksti? *(të këshillojë të rinjtë që dëshirojnë të gjejnë një punë për sezonin e verës)*
- Nga ndryshon paragrafi i fundit nga paragrafët e tjerë? *(tërheq më shumë vëmendjen e lexuesit, është konkluzioni më i rëndësishëm i tekstit etj.)*
- Fjalët e para të çdo paragrafi janë shkruar me shkronja të zeza? *(Fjalët e para shërbejnë si ide kryesore të tekstit). Cila është lidhja mes këtyre fjalëve dhe pjesës tjetër në paragrafët e tjerë? (sqarohen dhe/ose jepen shembuj të ideve kryesore)*
- A njihni të rinj që punojnë gjatë verës? *(sqarohet e drejta për të punuar pasi mbushet moshë). Çfarë keni mësuar nga rrëfimet ose përvojat e tyre?*
- Çfarë mësuar nga ky tekst? Mendoni se morët një informacion të dobishëm?

2.3. Përdorimi i TIK

Informacion

Interneti është një mjet komunikimi e argëtimi i përdorur në mbarë botën. Interneti tashmë nuk është më një risi për fëmijët dhe të rinjtë por një nevojë e domosdoshme për ata. Të gjithë kanë një sërë të drejtash që duhet të respektohen edhe në internet. Ata kanë të drejtën për të mos u shqetësuar, ofenduar apo ngacmuar nga përdoruesit e tjerë. Ata kanë të drejtë të komunikojnë dhe gjithashtu të argëtohen. Në anën tjetër, të gjithë kanë të drejtë të marrin informacione me përmbajtje të përshtatshme për moshën e tyre. Zhvillimet teknologjike kanë gjeneruar mundësi të reja që përfshijnë të drejtën për të prodhuar informacion, për të shprehur veten e tyre dhe për të dhënë ide. Tani ata janë protagonistë të internetit, dhe jo vetëm konsumatorët pasiv. Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë në vitet e fundit shoqërohet njëkohësisht edhe me ekspozimin e fëmijëve ndaj riskut të shfaqur si rrjedhojë e lundrimit jo të sigurt të tyre në internet. Prandaj ne si mësues duhet të marrim masa në mënyrë që fëmijët të jenë të sigurt gjatë lundrimit në internet.

- Interneti ofron burime të ndryshme informacioni dhe argëtimi. Burimet janë nga ato më të besueshmet, të licencuarat deri te faqet pirate të pa licencuara. Jo të gjitha përmbajtjet që janë në internet janë të përshtatshme për të gjitha moshat. Disa nuk rekomandohen të shikohen nga fëmijët e moshave nën 18 vjeç. Kjo për arsye se këto informacione mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre.
- “Cyberbullying” është kur një fëmijë apo një adoleshent është kërcënuar, keqtrajtuar, poshtëruar, tallur, ofenduar ose është vënë në shënjestër në mënyrë të qëllimshme nga një fëmijë ose adoleshent tjetër duke shfrytëzuar përdorimin e internetit, teknologjitë

interaktive dhe digjitale ose telefonat celularë. Cyberbullying zakonisht nuk është një komunikim i cili ndodh një herë, por ndodh në vazhdimësi.

- Interneti sot mundëson faqe të ndryshme të cilat ofrojnë argëtim nëpërmjet lojërave kompjuterike. Ju mund të luani me kompjuter, në telefonë celulare në rrjete sociale, etj.
- Termi “Varësi nga interneti” përdoret për të shpjeguar përdorimin e tepruar të internetit. Përdorimi i pakontrolluar i internetit mund të ndikojë negativisht në jetën e përditshme, në punë, dhe aspekte të tjera të jetës shoqërore. Mund të njihet edhe si varësia nga kompjuteri apo varësia online.
- Faqe të ndryshme në internet dhe rrjetet sociale, dhomat e chatit etj, ofrojnë mundësi të ndryshme krijimin e njohjeve të reja me miq të rinj virtual. Si rrjedhojë mund të takoni edhe njerëz të cilët nuk kanë asnjë qëllim të mirë ndaj jush. Ata përgjithësisht janë të rritur të cilët fshihen pas profileve dhe identiteteve false. Informacioni që ata përcjellin për vetëm e tyre mund të jetë i trilluar.

Veprimtaria 1: Përdorimi i TIK

Mësimdhënësi ka mundësi për t'i përfshirë nxënësit e klasës në një veprimtari komunikimi digjital nëpërmjet whatsapp apo mund të zhvillohet me dy kompjuterë me lidhje interneti ose me dy telefona. Gjithashtu mund të bëhet një komunikim në skype apo në internet duke klikuar për një temë që nxënësit propozojnë.

Reflektoni dhe diskutoni!

- Cilat janë llojet e komunikimit digjital që përdorni më shumë ?
- Si quhen aparatet me të cilat ne komunikojmë në mënyrë digjitale?
- Cilët janë disa nga lojërat digjitale që ju pëlqejnë më shumë?
- Pse përdorimi i shpeshtë i kompjuterëve dhe telefonave është i dëmshëm?
- Cilat janë disa nga rreziqet e lidhjes në internet me persona të panjohur?

2.4. Shkrimi dhe dërgimi i një e-maili

Veprimtaria 1: Komunikimi dikur


Kjo veprimtari synon që të përfshijë nxënësit në shkrimin e një letre duke treguar se deri 50 vite më parë letra brenda zarfit ishte forma më e përhapur e komunikimit mes njerëzve nga një qytet tek tjetri apo nga një kontinent tek tjetri. Mësuesi e ndan klasën në 4-5 grupe, duke i kërkuar secilit prej tyre të shkruajë një letër mbi temat e mëposhtme:

- Si është shkolla ime?
- Si po jeton familja ime?

- Çfarë ëndërroj të bëhem kur të rritem?
- Pushimet e mia.
- Ndërtimet në qytetin tim.

Përfaqësuesi i secilit grup prezanton letrën e shkruar dhe e vendos letrën në zarf, mbi të cilin është ngjitur një pullë poste dhe shkruhet adresa. Nxënësit diskutojnë rreth të gjitha këtyre detajeve.


Veprimtaria 2: Shkrimi dhe dërgimi i një e-maili




Hapat që ndiqen për shkrimin dhe dërgimin e një e-mail duke përdorur Gmail nga një kompjuter:

1. Shkoni tek <https://www.gmail.com/> në shfletuesin e internetit të kompjuterit tuaj. Kjo do të


hapë kutinë tuaj hyrëse të Gmail nëse jeni identifikuar. Nëse nuk jeni identifikuar në llogarinë tuaj Gmail, shkruani adresën tuaj të e-mail-it dhe fjalëkalimin kur ju kërkohet.



2. Klikoni + Compose. Është në anën e sipërme të majtë të kutisë suaj hyrëse të Gmail. Duke vepruar kështu, hapet një dritare "New message" në këndin e poshtëm djathtas të faqes.




3. Fusni adresën e e-mail-it të personit tjetër. Klikoni në kutinë e tekstit "To", më pas shkruani adresën e e-mail-it të personit të cilit dëshironi t'i dërgoni e-mail-in tuaj.




- Për të shtuar adresa të tjera e-mail-i, shkruani adresën e parë të e-mail-it, shtypni Tab dhe përsërisni me adresat e tjera të e-mail-it.
- Nëse dëshironi të CC ose BCC dikë në e-mail, klikoni ose lidhjen Cc ose lidhjen Bcc në anën e djathtë të fushës së tekstit "To", më pas shkruani adresën e e-mail-it që dëshironi të CC ose BCC

4. Shtoni një lëndë. Klikoni në fushën e tekstit "Subject", më pas shkruani çfarëdo që dëshironi të jetë subjekti i e-mailit. Në këtë mënyrë, një subjekt e-mail përshkruan thelbin e mesazhit të e-mail-it me disa fjalë.




5. Shkruani mesazhin tuaj të e-mail-it. Në kutinë e madhe të tekstit poshtë kutisë së tekstit "Subject", shkruani çfarëdo që dëshironi për mesazhin tuaj të emailit. P.Sh. një shoqe/shoku, një të afërmi, etj.



6. Formatoni tekstin e e-mail-it tuaj nëse është e nevojshme. Nëse dëshironi të aplikoni formatimin e tekstit tuaj (p.sh., me shkronja të theksuara, të pjerrëta ose pika), theksoni tekstin në të cilin dëshironi të aplikoni formatimin dhe më pas klikoni një nga opsionet e formatimit në fund të dritares së emailit.

- Për shembull, për të theksuar një pjesë të tekstit, duhet të




përzgjidhni tekstin dhe më pas të klikoni **B** në fund të e-mail-it.

7. Bashkangjitni një skedar nëse dëshironi. Për të shtuar një skedar nga kompjuteri juaj, klikoni imazhin "Attach"  më pas zgjidhni skedarin(et) që dëshironi të ngarkoni dhe klikoni Open.

- Ju mund të shtoni foto në këtë mënyrë, ose mund të ngarkoni foto direkt duke klikuar

ikonën "Photos"  në fund të dritares, duke klikuar Upload dhe duke zgjedhur fotot sipas nevojës.



8. Klikoni Send. Është një buton blu në këndin e poshtëm majtas të dritares së postës elektronike. Duke vepruar kështu, do të dërgoni emailin tuaj në adresën(at) e specifikuar në e-mail-it.

Ushtrim

Duke vepruar në mënyrën e mësipërme mësimdhënësi e ndan klasën në 4-5 grupe, duke i kërkuar secilit grup të shkruajë një e-mail mbi temat e mëposhtme dhe më pas ta dërgojnë atë.

- E-mail shoqes/shokut të ngushtë.
- E-mail shoqes/shokut të ngushtë në gjuhë të huaj.

- E-mail që kërkoni të aplikoni për punë.
- E-mail një familjari që keni kohë pa e parë.

Përfaqësuesi i secilit grup prezanton hapat që kanë ndjekur për shkrimin dhe dërgimit e e-mail-it.

2.5. Njësitë matëse matematikore

Veprimtaria 1: Plotësojmë së bashku

Mësuesi fton secilin nxënës të plotësojë fletët e punës më poshtë për kryerjen e njehsimeve të njësive matëse dhe më pas diskutojnë së bashku përfundimet.

Konvertoni njësitë

1. 79 g = _____ kg 2. 7.9 g = _____ kg

3. 78 kg = _____ g 4. 0.18 g = _____ kg

5. 69 g = _____ kg 6. 0.31 kg = _____ g

7. 0.56 mL = _____ L 8. 24 g = _____ kg

9. 0.12 kg = _____ g 10. 7.8 L = _____ mL

11. 8.3 g = _____ kg 12. 7.3 L = _____ mL

13. 5.8 L = _____ mL 14. 0.12 L = _____ mL

15. 6.3 g = _____ kg 16. 0.53 g = _____ kg

17. 8.6 g = _____ kg 18. 1.7 L = _____ mL

Konvertoni njësitë

1. 37 cm = _____ mm 2. 927 m = _____ cm

3. 598 m = _____ cm 4. 20 m = _____ cm

5. 914 m = _____ cm 6. 58 m = _____ cm

7. 863 m = _____ cm 8. 626 cm = _____ mm

9. 38 m = _____ cm 10. 771 m = _____ cm

11. 18 m = _____ mm 12. 442 cm = _____ mm

13. 34 m = _____ mm 14. 646 m = _____ mm

15. 704 m = _____ cm 16. 584 m = _____ cm

17. 830 cm = _____ mm 18. 23 m = _____ cm

MODULI 3: MATEMATIKA, TIK-u DHE KOMUNIKIMI NË PROFESIONIN TIM

Nr.	Njohuritë dhe aftësitë për modulin
3.1.	Atributet dhe aftësitë personale
3.2.	Aftësitë digjitale në përpunimin e tekstit digjital
3.3.	Aftësitë e komunikimit dhe lexim shkrimit
3.4.	Aftësitë matematikore
3.5.	Jetë e shëndetshme


Nëpërmjet veprimtarive praktike të paraqitura në modulin “Matematika, TIK-u dhe komunikimi në profesionin tim” nxënësi ndërton në mënyrë të integruar aftësitë bazë të të folurit, të shkruarit, të lexuarit, të matematikës, digjitale, aftësitë e të menduarit kritik, aftësitë e zgjidhjes së problemit, aftësitë personale, qytetare, të orientimit për karrierë etj.

Rezultatet e të nxënësit

Nxënësi:

- ✓ eksploron aftësitë e komunikimit ndërpersonal dhe në grup;
- ✓ identifikon dhe diskuton perceptimet për veten, duke përfshirë atributet/tiparet personale;
- ✓ zhvillon aftësitë e përpunimit të tekstit digjital;
- ✓ demonstroi të kuptuarit e informacionit të tekstit;
- ✓ shkruan një tekst të shkurtër në varësi të qëllimit që ka;
- ✓ zbaton rregullat kryesore drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- ✓ bën prezantime formale dhe merr pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme;
- ✓ kryen veprime matematikore;
- ✓ ndërvepron pozitivisht dhe në mënyrë efektive me të tjerët.

3.1. Atributet dhe aftësitë personale



Informacion

Aftësitë personale dhe atributet luajnë një rol të rëndësishëm në mundësitë tona për zgjedhjen e profesionit.

Cili është ndryshimi midis aftësive dhe attributeve?

- ✓ Atribut është një tipar ose një cilësi e veçantë me të cilën një individ lind, si psh: sens humori, motivimi, besnikëria, etj.
- ✓ Aftësitë janë zotësi të caktuara që njerëzit i

mësojnë dhe zhvillojnë përmes praktikës.

Dallimi midis këtyre të dyjave rrjedh nga fakti që atributi është një cilësi e qenësishme, ndërsa aftësitë duhet të mësohen dhe praktikohen.

Nxënësit duhet të njohin aftësitë e tyre dhe të identifikojnë ato që kanë tashmë dhe ato që mund t'u duhet të marrin në konsideratë për punë të veçanta.

Nxënësit e perceptojnë veten se kanë disatribute, por shpeshherë ata nuk i mendojnë atributet që kanë të lidhura me punën. Ata duhet të ndërgjegjësohen se si mund t'i ndërtojnë atributet e tyre për të fituar punë.

Ekziston një marrëveshje e gjerë që të gjithë të rinjtë kanë nevojë për një sërë aftësish dhe atributesh që do t'i përgatisin ata si për punësim ashtu edhe për të mësuarin e mëtejshëm.

Aftësitë kryesore të identifikuara në lidhje me atributet personale janë:

- aftësitë e komunikimit që kontribuojnë në marrëdhënie produktive dhe harmonike ndërmjet punonjësve dhe klientëve;
- aftësitë e punës në grup që kontribuojnë në marrëdhëniet dhe rezultatet produktive të punës;
- aftësi për zgjidhjen e problemeve që kontribuojnë në rezultate novatore;
- aftësitë e iniciativës dhe sipërmarrjes që kontribuojnë në rezultate inovative;
- aftësitë e vetë-menaxhimit që kontribuojnë në kënaqësinë dhe rritjen e punonjësve;
- aftësitë e të mësuarit që kontribuojnë në përmirësimin dhe zgjerimin e vazhdueshëm në operacionet dhe rezultatet e punonjësve dhe të kompanisë;
- aftësitë e planifikimit dhe organizimit që kontribuojnë në planifikimin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër;
- aftësi teknologjike që kontribuojnë në ekzekutimin efektiv të detyrave.



Atributet (tiparet) personale të mëposhtme kontribuojnë në punësimin dhe karrierën tuaj në të ardhmen:

- besnikëria
- angazhimi
- ndershmëria dhe integriteti
- entuziazmi
- besueshmëria
- prezantimi personal
- vetëvlerësimi pozitiv
- sens humori
- qëndrim i ekuilibruar ndaj punës dhe jetës në shtëpi
- aftësia për të përballuar presionin
- motivimi
- përshtatshmëri.

Veprimtaria 1

Ky veprimtari është krijuar që ju të vlerësoni atributet/tiparet tuaja personale dhe të identifikoni ato në të cilat jeni të shkëlqyer. Kjo do t'ju ndihmojë të identifikoni mundësitë e punës/profesionit që mund të dëshironi të merrni në konsideratë. Fillimisht plotësoni tabelën e mëposhtme duke vlerësuar veten me 1, 2, 3 ose 4 në kutinë "Vlerësimi im".

Shkalla e vlerësimit: 1– 4

1 = Shkëlqyeshëm

2 = Shumë mirë

3 = Mirë

4 = Ka nevojë për përmirësim

Atributi/Tipari	Vlerësimi im	Atributi/Tipari	Vlerësimi im	Atributi/Tipari	Vlerësimi im
I sinqertë		Besnik		I pëlqen shkolla	
I besueshëm		I pashëm		I pëlqen sporti	
Tregon sens të përbashkët		I gëzuar		Merr iniciativa	
Krijon lehtësisht miq		I përgjegjshëm		I ndihmon njerëzit e tjerë	
Sens humori		Entuziast		I organizuar	
I besueshëm		E veshur mirë		I sinqertë	

Veprimtaria 2:

Pasi të keni plotësuar tabelën më sipër shkruani secilin nga atributet/tiparet tuaja në katër kutitë më poshtë sipas vlerësimit që i dhatë vetes.

Klasifikimi 1 (Shkëlqyeshëm)	Klasifikimi 2 (Shumë mirë)
Klasifikimi 3 (Mirë)	Klasifikimi 4 (Ka nevojë për përmirësim)

Veprimtaria 3:

Më pas kërkojuni shokëve tuaj t'ju vlerësojnë si 1, 2, 3 ose 4 në kutinë “vlerësimi im” dhe krahasoni vlerësimin tuaj me ato që ju kanë dhënë shokët tuaj. Më poshtë kemi dhënë një tabelë bosh për ju që ta përdorni për të përfunduar veprimtarinë me ta. Shokët tuaj do ju vlerësojnë me 1, 2, 3 ose 4 në kutinë "Vlerësimi im".

Shkalla e vlerësimit: 1– 4

1 = Shkëlqyeshëm

2 = Shumë mirë

3 = Mirë

4 = Ka nevojë për përmirësim

Atributi/Tipari	Vlerësimi im	Atributi/Tipari	Vlerësimi im	Atributi/Tipari	Vlerësimi im
I sinqertë		Besnik		I pëlqen shkolla	
I besueshëm		I pashëm		I pëlqen sporti	
Tregon sens të përbashkët		I gëzuar		Merr iniciativa	

Krijon lehtësisht miq		I përgjegjës		I ndihmon njerëzit e tjerë	
Sens humori		Entuziast		I organizuar	
I besueshëm		E veshur mirë		I sigurtë	

Veprimtaria 4:

Pasi të keni plotësuar tabelën më sipër shkruani secilin nga atributet/tiparet tuaja në katër kutitë më poshtë sipas vlerësimit që morrët.

Klasifikimi 1 (Shkëlqyeshëm)	Klasifikimi 2 (Shumë mirë)
Klasifikimi 3 (Mirë)	Klasifikimi 4 (Ka nevojë për përmirësim)

Veprimtaria 5:

Krahasoni vlerësimin duke ju përgjigjur pyetjeve të mëposhtme

– Cilat attribute/tipare morën po të njëjtin vlerësim nga ju dhe nga shokët tuaj?	
– Në cilat attribute/tipare menduat se ishit të mirë, por morët një vlerësim jo të mirë nga shokët tuaj?	
– Cilat attribute/tipare u vlerësuan si 'Shkëlqyeshme' nga ju dhe shokët tuaj?	
– Cilat attribute/tipare u vlerësuan "Ka nevojë për përmirësim"? Dëshironi t'i përmirësoni këto attribute/tipare? Nëse po, çfarë hapash do të ndërmerreni për t'i përmirësuar ato?	

– Cilat profesione do të kishin nevojë për atributet/tiparet që ju u vlerësuar “Shkëlqyeshëm”?	
– A kërkon ndonjë profesion që keni marrë në konsideratë attribute/tipare që 'kanë nevojë për përmirësim? Nëse po, cilat janë disa nga opsionet tuaja?	

Veprimtaria 5: Vlerësimi i aftësive të mia



Përdoreni fletën e listës së kontrollit më poshtë për të përditësuar listën e aftësive tuaja.

- Shikoni aftësitë që keni punuar tashmë në fletët e mëparshme të punës.
- Tani plotësoni këtë listë kontrolli duke shkruar të gjitha gjërat në të cilat jeni shumë të mirë.
- Nxënësit plotësojnë individualisht fletën e punës së listës kontrolluese dhe më pas marrin pjesë në diskutime në grupe të vogla për gjetjet e tyre

Aftësitë e mia	Si e kam mësuar këtë aftësi?	Ku e aplikoj këtë aftësi?	Një punë që kërkon këtë aftësi

3.2. Aftësitë digjitale në përpunimin e tekstit digjital

Për përpunimin e tekstit digjital mësuesi ndërmer veprimtari, të cilat synojnë avancimin dhe përvetësimin e aftësive të nxënësve në krijimin dhe përpunimin e dokumenteve digjitale. Në fillim të orës mësimore mësuesi fton nxënësit të hapin programin Microsoft word dhe zhvillon

diskutime lidhur me qëllimin e përdorimit të këtij programi nga ana e tyre. Inkurajon nxënësit të ndajnë me njëri-tjetrin ide mbi llojet e ndryshme të materialeve dhe dokumenteve që ata mund të krijojnë duke përdorur këtë program. Mbi bazën e njohurive aktuale të nxënësve, mësuesi bën një prezantim të shkurtër mbi qëllimin e përdorimit të programit Microsoft Word si dhe prezanton rubrikat kryesore, paletën e mjeteve të punës, si dhe komandat më të rëndësishme që nxënësit duhet të njohin.


Veprimtaria 1: Përpunimi i dokumenteve nëpërmjet programeve të përpunimit të tekstit digjital

Mësuesi iu shpërndan nxënësve paraprakisht një tekst të printuar në një format A4 dhe i udhëzon nxënësit të kopjojnë materialin në një dokument. Brenda një limiti kohor prej 5 minutash, nxënësit duhet të stopojnë punën e tyre dhe më pas mësuesi kontrollon materialet e gjithsecilit për të parë se deri në çfarë mase është riprodhuar teksti.

Veprimtaria 2: Përdorim programin type

Mësuesi i fton nxënësit të hapin adresën <https://www.typedojo.com/wpm-test/> dhe inkurajon ata të zhvillojnë një typing test, për të parë dhe vlerësuar shkathtësinë e ndërveprimit të tyre me tastierën dhe tastet kryesore. Në fund të çdo tentative dhe testi të realizuar nga ana e nxënësit, platforma gjeneron informacione lidhur me:

- Numrin e tasteve të shtypura brenda 1 minute
- Numrin e tasteve të sakta të shtypura brenda 1 minute
- Numrin e tasteve të gabuara të shtypura brenda 1 minute
- Numrin e fjalëve të shkruar brenda 1 minute
- Shkallën e gabimeve



3.3. Aftësitë e komunikimit dhe lexim -shkrimit



Veprimtaria 1: Flluska dhe retë

Filloni me një veprimtari i cili do t'i ndihmojë nxënësit të bëjnë dallimin mes një opinioni dhe një fakti.


Bisedë hyrëse e mësuesit: Për të filluar një punë të re, në të shumtën e herëve zhvillohet një intervistë mes personit që kërkon punë dhe punëdhënësit. Ky proces është i rëndësishëm për të dyja palët: ai që kërkon punë dëshiron që ta bindë punëdhënësin për vlerat dhe aftësitë e veta, ndërsa punëdhënësi të për zgjedhë atë që është më i përshtatshëm për punën e tij.

- Mësuesi ndan nxënësit në grupe. Ai sqaron nxënësit se një mendim pa zë mund të vizatohet si re dhe një mendim që i shprehim dhe ua komunikojmë të tjerëve, mund të vizatohen si fluskë.
- Nxënësit do të plotësojnë një re dhe një fluskë për personin që kërkon punë dhe një re dhe një fluskë për punëdhënësin.

Shembull:



Punëmarrësi:



Pasi nxënësit kanë plotësuar dy retë dhe dy fluskat, i lexojnë ato. Nxënësit diskutojnë për përgjigjet e njëri- tjetrit. Pastaj nxënësit ndërrojnë fletët me njëri- tjetrin dhe vlerësojnë nëse janë ndjekur ose jo nga shokët/shoqet tyre rregullat kryesore drejtshkimore, si p.sh., përdorimi i shkronjës së madhe, i shenjave të pikësimit, i numrit shumës në vetën e dytë (ju), i ligjëratës së drejtë etj.

Shënim: Kjo veprimtari mund të zhvillohet me stilolaps dhe letër, por edhe me kompjuter.

Veprimtaria 2: Plotësoj një kërkesë pune

(shih formularin e kërkesës për punë- fletë pune)

Mësuesi hap në kompjuter formularin e mëposhtëm (Kërkesë për punë) dhe udhëzon nxënësit të plotësojnë disa të dhëna (jo të gjitha) në rubrikat 1, 3 dhe 4 të formularit të kërkesës për punë. Mësuesi udhëzon dhe monitoron nxënësit për plotësimin dhe saktësinë e të dhënave.

Për plotësimin e rubrikës 2 kërkohet të plotësohet nga nxënësit, duke iu përmbajtur kritereve të mëposhtme:

- Ju dëshironi të punoni gjithsej 15 orë në javë, duke filluar punën në orën 4 pasdite.
- Ju doni të punoni dy ose më shumë ditë në javë, po jo të shtunën dhe të dielën.
- Ju jetoni vetëm 2 kilometra larg restorantit, pranë një linje autobusi që ju çon drejt e në punë.
- Një mik ju ka folur për këtë vend pune.

Mësuesi vlerëson plotësimet e nxënësve, të cilët mund të punojnë individualisht ose në çift.

Fletë pune: Formulari i kërkesës për punë

Kërkesë për punë

1. Të dhëna të përgjithshme

Emri, atësia, mbiemri: _____

Numri i celularit: _____

Adresa, rruga: _____ Sh/ap: _____

Qyteti: _____ Rrethi: _____ Kodi postar: _____

Jeni 18 vjeç apo më i madh? _____ (po/jo) Mosha: _____

Keni punuar më parë në restorantin tonë? _____

Nëse po, koha dhe puna që keni bërë: _____

2. Disponueshmëria

Nr. i orëve të lira në javë: _____

Orët kur jeni i lirë:

	H	M	M	E	P	SH	D
Nga ora							
Deri							

Si jeni informuar për këtë vend pune? _____

Sa larg banoni nga restoranti? _____

A keni mjet transporti për të shkuar në punë? _____

3. Shkolla e ndjekur së fundmi:

Emri i shkollës: _____

Dega: _____

Klasa e fundit që keni kryer: _____

Nota mesatare: _____

I diplomuar: _____ (po/jo)

I sapo regjistruar: _____ (po/jo)

Sporte ose veprimtari: _____

4. Puna e fundit: (Në qoftë se nuk keni, përmendni një punë që keni bërë në mënyrë vullnetare ose rekomandim personal)

Ndërmarrja: _____

Vendi: _____

Pozicioni: _____

3.4. Aftësitë matematikore

Veprimtaria 1: Prodhimi i bukës

Në tabelën e mëposhtme tregohet përbërja e bukës së bardhë si edhe ajo e bukës së integruar (për 100 g të secilës).

Cilësia	Ujë	Fibra	Sheqerna të ngadalshme	Sheqerna të shpejta	Proteina	Yndyrna
Bukë e bardhë	30g	3g	58,5g	0,5g	7g	1g
Bukë integrale	35g	7g	46,9g	0,5g	9g	1,8g

Klasa ndahet në grupe.

Grupi i parë

Nëse ju bleni një bukë që peshon 75g ose 125 g ose 200g ose 400 gr bukë sa përbërës janë. Secili grup vendos të dhënat në një tabelë.

Mielli i grurit përbën mesatarisht $\frac{3}{5}$ e masës së bukës. Sa miell ka në secilin prej rasteve të grupeve.

Grupi i dytë

Nëse ju keni afërsisht 1 m² tokë bujqësore dhe në të prodhoni $\frac{2}{3}$ kg miell gruri, sa kg miell mund të prodhoni në 7,5 ha tokë bujqësore?

Grupi i tretë

Sot një banor konsumon mesatarisht 108 kg bukë në vit. Për ç'sipërfaqe bujqësore ka nevojë vendi ynë, për të mbajtur me bukë 3 milion banorët e tij?

Veprimtaria 2: Receta të ndryshme

Mësuesi ndan klasën në grupe dhe secilin grup i jep të bëj llogaritjet për një recetë ushqimore. Në përfundim grupet prezantojnë recetën e tyre dhe diskutojnë saktësinë e rezultatit duke vlerësuar punën e njëri –tjetrit.

<i>Grupi i parë</i> <i>Përgatisim ponç</i>	<i>Grupi i dytë</i> <i>Përgatisim byrek</i>	<i>Grupi i dytë</i> <i>Përgatisim biskota</i>
Për të bërë ponç frutash, përdorni lëng portokalli, lëng ananasi, lëng xhinxheri dhe lëng boronice përkatësisht në raportin 3 : 3 : 4 : 8. Ju do të bëni 9 litra ponç frutash, sa litra nga secili përbërës do të përdornit?	Ju do të përgatisni brumin e byrekut. Raporti i masës së qumështit me miellin në një recetë brumi, është 2 : 3. a) Sa qumësht dhe sa miell nevojiten për një kg brumë? b) Sa qumësht nevojitet për t'u përzier me 450 g miell?	Për të bërë brumin bazë të biskotave, ju do përdorni sheqer, gjalpë dhe miell përkatësisht në raportin 1 : 2 : 3. Nëse dëshironi të bëni 15 kilogramë brumë biskotash, sa nga secili përbërës do të përdornit?
<i>Prezantoni dhe diskutoni rezultatet me grupet e tjera</i>	<i>Prezantoni dhe diskutoni rezultatet me grupet e tjera</i>	<i>Prezantoni dhe diskutoni rezultatet me grupet e tjera</i>

3.5. Jetë e shëndetshme

Veprimtaria 1

Mësuesi fton nxënësit të lexojnë tregimin për familjen Kastrioti (*tregimi ndodhet në fletën e punës: Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes. Lista e këshillave*). Në punë dyshe nxënësit shkruajnë shprehitë pozitive dhe negative, të cilat i praktikon familja Kastrioti.

Shprehitë pozitive	Shprehitë negative	Po unë?

- Diskutohen punët e nxënësve dhe ftohen të tregojnë nëse njohin ndonjë shok, të afërm ose vetë ata që ngjajnë me personazhet e këtij tregimi.
- Pas diskutimit mësuesi u shpërndan nxënësve *Fletën e punës 1 “Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes. Lista e këshillave”*.
- Nxënësit ushtrohen në grup dhe udhëzohen që ata do të jenë në rolin e mjekut ose të këshilltarit, i cili duhet të bëjë një listë me këshilla dhe rekomandime, të cilat do të çonin në ndryshimin e shprehive të zakonshme të përditshme të mënyrës së jetesës së familjes Kastrioti.
- Pas përfundimit mësuesi i fton nxënësit që në grupe të prezantojnë punën e tyre në role para klasës.

Fletë pune 1

Shprehitë (jo) të shëndetshme të familjes

Lista e këshillave

Genti dhe Albana janë fëmijët e familjes Kastrioti. Prindërit e tyre janë shumë të mërzitur me ta. Ata gjithmonë ua kanë plotësuar të gjitha dëshirat dhe kërkesat e fëmijëve të tyre. Fëmijët vendosnin vetë se çfarë do të blinin kur shkonin në dyqan. Kështu që qeset e tyre ishin të mbushura me lloje të ndryshme të patatinave, çokollatave, bonboneve, lëngjeve, karamele e çdo gjë tjetër. Në shtëpi Genti dhe Albana uleshin pranë kompjuterit ose televizorit dhe me orë të tëra qëndronin para tyre duke ngrënë nga gjërat e blera.

Kjo ishte përditshmëria e dy fëmijëve. Kur shokët e tyre i ftonin që të luanin, Genti dhe Albana asnjëherë nuk shkonin. Shpesh shkonin për vizita tek miqtë e prindërve të tyre, dhe aty pinin edhe pije të gazuara. Ata qëndronin atje deri në orët e vona, ndërsa binin në gjumë pas mesnate. Në mëngjes ishin nervoz, të lodhur, ndërsa gjatë orëve të mësimi ishin të rraskapitur dhe të

papërqendruar. Gjatë kohës së pushimit ata shpesh ziheshin me moshatarët e tyre. Mësuesja e vërejti këtë sjellje të tyre dhe thirri menjëherë prindërit e tyre në shkollë. Pas një bisede të gjatë prindërit kuptuan se diçka nuk shkonte me fëmijët e tyre. Për këtë shkuan tek mjeku dhe kërkuan ndihmë. Mjeku i ftoi prindërit që t'i shpjegonin se çfarë hanë fëmijët e tyre, sa kohë kalojnë duke mësuar, e sa duke luajtur, zbavitur, shëtitur dhe argëtuar, sa herë në javë merren me sport dhe sa herë brenda ditës kalojnë para televizorit dhe kompjuterit.

Pas shpjegimit, mjeku u dha këshillat në vijim:

Lista e këshillave

	Patjetër ta ndryshoni mënyrën e të ushqyerit te fëmijët tuaj, sepse kjo është.....
	Menjëherë t'i regjistroni në ndonjë Veprimtari sportiv
	E treta
	E katërta
	E pesta

Veprimtaria 2

Mësuesi fton nxënësit të shprehin mendimet e tyre rreth temës “Jetë e shëndetshme”. Në tabelë renditen të gjitha rregullat (ushqimi i shëndetshëm, sport, pushim, argëtim, kujdes shëndetësor, vaksinim, regjim ditor) që duhen respektuar për të pasur një jetë të shëndetshme. Nxënësit diskutojnë dhe sjellin shembuj nga jeta e përditshme e tyre.

- Mësuesi u shpërndan nxënësve *Fletën e punës 2* “Lista e këshillave për një jetë të shëndetshme”. Nxënësve u shpjegohet se në fushat “Respektoj/Nuk respektoj/Si t’i përmirësoj shprehinë” të shkruajnë për shprehinë e jetës së tyre.
- Insistohet që nxënësit të jenë të vërtetë, sepse vetëm kështu ata do të mund të realizojnë fotografinë reale për mënyrën e jetesës së tyre. Nëse nxënësit kanë shënuar për disa nga rregullat “Nuk i respektoj”, ftohen që të shkruajnë se si t’i përmirësojnë shprehinë e tyre për një jetë të shëndetshme. Shprehinë e reja t’i shkruajnë në kolonën e fundit.
- Pas përfundimit të punës nxënësit ftohen të prezantojnë para klasës “Jetesën e tyre të shëndetshme”.
- Diskutohen rregullat që duhet të respektojnë dhe ato që duhet të përmirësojnë si dhe kërkohet që të argumentojnë me shembuj nga jeta se plotësimi dhe respektimi i rregullave është përgjegjësi për të pasur një shëndet sa më të mirë.

Fletë pune 2

Lista e këshillave për një jetë të shëndetshme

<i>Që jeta jonë të jetë sa më e shëndetshme</i>	<i>Respektoj</i>	<i>Nuk</i>	<i>Si t’i</i>
<i>duhet të respektojmë rregullat në vijim</i>		<i>respektoj</i>	<i>përmirësoj shprehinë</i>

	Ha shpesh fruta dhe perime
	U shmangem ëmbëlsirave
	Shpesh eci në këmbë
	Bëj sport
	Para kompjuterit kaloj më pak se një orë në ditë
	Gjatë kohës së lirë shpesh luaj lojëra të ndryshme me

	shoqet/shokët e mi në natyrë Në mbrëmje bie në gjumë herët
	Më pëlqen të lexoj libra
	Në televizor shikoj vetëm emisione të përshtatshme për moshën time
	Të paktën një herë në javë unë me familjen dalim shëtitje në natyrë

MODULI 4: Turizmi

Nr.	Njohuritë dhe aftësitë për modulin
4.1	Turizmi në Shqipëri dhe llojet e tij
4.2	Aftësitë e komunikimit
4.3	Aftësitë TIK
4.4	Zhvillimi i qendrueshëm
4.5	Aftësitë matematikore

Nëpërmjet veprimtarive praktike të paraqitura në modulin “Turizmi” nxënësi ndërton në mënyrë të integruar aftësitë bazë të të folurit, të shkruarit, të lexuarit, të matematikës, digjitale, aftësitë e të menduarit kritik, aftësitë e zgjidhjes së problemit, aftësitë personale, qytetare, të orientimit për karrierë etj.

Rezultatet e të nxënës


Nxënësi:

- ✓ familjarizohet me termat/konceptet: turizëm, vend turistik, objekt historik-kulturor;
- ✓ përcakton disa prej qyteteve turistike të Shqipërisë;
- ✓ tregon llojet e turizmit që zhvillohen në Shqipëri;
- ✓ identifikon objektet historike dhe kulturore të qytetit të tij;
- ✓ ndërton internerarin e pikave më atraktive të qytetit të tij.
- ✓ përdor motorët e kërkimit në internet;
- ✓ demonstroi të kuptuarit e tekstit;
- ✓ identifikon funksionet që kanë elementet gjuhësore në tekst;
- ✓ shpreh opinionin e tij rreth teksteve;
- ✓ identifikon faktin dhe opinionin, si dhe problemin dhe zgjidhjen e tij;
- ✓ merr pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tij;
- ✓ kryen veprime matematikore;

4.1. Turizmi në Shqipëri dhe llojet e tij

Veprimtaria 1: Identifikojmë qytetin turistik

Mësuesi prezanton nxënësit me fotot e përzgjedhura më poshtë të disa qyteteve të Shqipërisë dhe i fton ata ti shohin dhe të identifikojnë se cili qytet është. Më pas ai ju kërkon nxënësve të tregojnë se cilat nga këto qytete apo të tjerë kanë vizituar dhe çfarë ju ka pëlqyer më shumë në qytetin që kanë vizituar?





Veprimtaria 2: Luajmë me shishe



Organizojmë nxënësit të qëndrojnë në një rreth dhe mësuesi rrotullon shishen. Kapaku i shishes tregon njërin nxënës dhe baza e shishes tregon nxënësin tjetër. Nxënësit që i ka rënë baza e shishes mund t'i bëjë një pyetje nga pyetjet e përgatitura më poshtë ose dhe të tjera nxënësit që i ka rënë kapaku. Ky i fundit duhet të përgjigjet pyetjes së shokut. Kështu vazhdon me radhë

derisa përfundojnë pyetjet që mësuesi ose nxënësit kanë përgatitur.


Nxënësit diskutojnë të gjithë së bashku rreth pyetjeve të mëposhtme dhe të tjera:

- Cila është dita botërore e turizmit (27 shtator)?
- A keni foto tuajat me pushime?
- Çfarë të pëlqen të bësh në vendin që shkon si turist?
- Çfarë ju pëlqen më shumë deti, mali, objektet historike, fshati, apo të shijoni ushqimin?
- Cilat objekte turistike ju pëlqen të vizitoni?
- Cili lloj turizmi ju pëlqen më shumë dhe pse?
- Cilat janë disa nga objektet turistike më të vizitueshme në Shqipëri?
- Cili është ushqimi karakteristik që të ka pëlqyer më shumë në një qytet apo një vend që ke shkuar?
- Çfarë bën një turist në Shqipëri?
- Kë shtet dëshironi të vizitoni dhe pse?
- Keni dëgjuar për llixhat në Shqipëri?



- Çfarë do të quani turizëm sportiv?
- A e dini çfarë është agroturizmi? A keni qenë në ndonjë fermë ose bujtinë? Ku çfarë dhe pse ju ka pëlqyer?
- Sot do të zgjidhni të pushoni në mal, në det apo në pishina? Argumentoni zgjedhjen tuaj.

Veprimtaria 3: Llojet e turizmit




Nxënësit lidhin fotot e mëposhtme me llojin e turizmit më sipër





Veprimtaria 4: Ndërtojmë itinerarin e pikave turistike të qytetit tuaj

Mësuesi pyet nxënësit se çfarë na ofron qyteti ku ne jetojmë. Pasi nxënësit kanë përcaktuar atraksionet dhe pikat turistike të qytetit, mësuesi fton nxënësit të ndërtojnë së bashku një itinerar se si mund ta vizitojmë qytetin e tyre. Ai jep udhëzime për përdorimin e google map për të identifikuar pikat turistike që ofron qyteti. Nxënësit gjejnë në google cilat janë atraksionet dhe pikat turistike të qytetit.



4.2. Aftësitë e komunikimit

Veprimtaria 1: Flas për Kadarenë dhe romanin “Kronikë në gur”

“Kronikë në gur” Ismail KADARE

(lexoni me vëmendje fragmentin)

Ky ishte një qytet i çuditshëm, që dukej sikur kishte dalë në luginë papritur një natë dimri si një qenie prehistorike dhe, duke u kacavjerrë me mundime të mëdha, i ishte qepur faqes së malit. Gjithçka në këtë qytet ishte e vjetër dhe e gurtë, duke filluar që nga rrugët dhe çezmat e gjer te çatitë e shtëpive të tij të mëdha, shekullore, që ishin të mbuluara me pllaka guri ngjyrë gri, të cilat u ngjanin luspave gjigande. Ishte e vështirë të besoje se nën ato korraca të forta gjallonte mishi i butë i jetës. Çdo udhëtari, që e shikonte për herë të parë, qyteti i zgjonte dëshirën për të bërë një krahasim, por menjëherë pasi udhëtari binte në grackë, qyteti e flakte krahasimin, sepse ky ishte një qytet që nuk ngjante me asgjë. Ai nuk i mbante gjatë krahasimet, ashtu siç nuk mbante gjatë shirat, breshërin, ylberet dhe flamurët e shumëngjyrshëm të huaj, që iknin siç vinin mbi çatitë e tij, aq të përkohshëm e irealë sa ç’ ishte i përjetshëm dhe konkret. Ky ishte një qytet i pjerrët, ndoshta më i pjerrëti në botë, që i kishte thyer të gjitha ligjet e arkitekturës dhe të urbanistikës. Nga shkaku i pjerrësisë së madhe ndodhte që në nivelin e çatisë së njërës shtëpi gjendeshin themelet e tjetrës, dhe me siguri ky ishte i vetmi vend në botë ku njeriu, po të rrëzohej në anë të rrugës, në vend që të binte në hendek, mund të binte mbi çatinë e ndonjë shtëpie të lartë. Këtë gjë më mirë se kushdo e dinin pijanecët. Ishte me të vërtetë një qytet shumë i çuditshëm. Ti mund të ecje rrugës dhe po të doje, mund të zgjatje pak krahun dhe të vije kapelën tënde mbi majën e një minareje. Shumë gjëra këtu ishin të pabesueshme dhe shumë gjëra ishin si në ëndrra.

Duke ruajtur me vështirësi jetën njerëzore në gjymtyrët dhe nën lëvozhgën e tij të gurtë, qyteti i shkaktonte asaj pa dashur shumë dhimbje, gërvishtje dhe plagë, dhe kjo ishte një gjë e natyrshme, përderisa ky ishte një qytet prej guri dhe çdo prekje e tij ishte e ashpër dhe e ftohtë. Ishte e vështirë të ishe fëmijë në këtë qytet.


Mësuesi zhvillon një diskutim të shkurtër rreth Kadaresë.

- Çfarë dini për Kadarenë?
- A keni lexuar ndonjë libër/ fragment/ poezi të tij?
- A ju pëlqeu fragmenti i mësipërm? Pse?
- Kadare nuk e përmend Gjirokastrën në romanin e tij “Kronikë në gur”. Nga kuptohet që fragmenti i mësipërm i referohet Gjirokastrës?
- A do t’ua rekomandonit Gjirokastrën të tjerëve për ta vizituar?

Veprimtaria 2: Bëj një kllastër me mbiemra

Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe u jep si detyrë të bëjnë një kllaster (në një fletë ose në kompjuter), duke u bazuar në mbiemrat e dhënë në tekst për qytetin.

Shembull:



Nxënësit prezantojnë kllasterin dhe plotësojnë njëri- tjetrin.

Mësuesi i pyet nxënësit: Çfarë funksioni kanë mbiemrit në këtë rast? *(I japin mundësi lexuesit ta përfytyrojë më mirë qytetin; e bën gjuhën e tekstit më shprehëse, etj.).*

4.3. Aftësitë TIK

Veprimtaria 1: Agjent udhëtimesh

Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe u thotë:

Mendojeni veten tuaj si një grup udhërrëfyesish (guidë), detyra e të cilëve është të promovojnë qytetin e Gjirokastrës ose qytetin e tij.


Si grup, ju duhet të krijoni një hartë koncepti të të gjitha gjërave emocionuese dhe interesante në këtë qytet dhe më pas ua paraqisni të tjerëve.

Mos harroni teatrot, restorantet, sportet, veprimtaritë, argëtimet dhe shumë më tepër.

Nëse nuk keni shumë detaje për vendndodhjen tuaj, bëni disa kërkime në internet dhe më pas i përfshini ato.

Veprimtaria 2: Një status në rrjetet sociale

Imagjinoni sikur jeni administrator i një faqeje në facebook ose në instagram, ose në të titter për qytetin e Gjirokastrës ose qytetin tuaj. Hartoni një status për një ngjarje, për të dhënë një informacion që tërheq turistët dhe shoqërojeni me foto.



Shembull:

Statusi: Me arkitekturën e veçantë, pasuritë e shumta kulturore, mikpritjen dhe bujarinë e qytetarëve, hotelet e pastra, shtëpitë dhe rrugët e kalldrëmta, ushqimet me shije dhe tradicionale. Gjirokastra ju fton të jetoni një përvojë unike dhe të paharrueshme si turistë.

4.4. Zhvillimi i qëndrueshëm

Informacion

Ripërdorimi dhe riciklimi i materialeve të ndryshme janë një praktikë shumë e mirë jo vetëm për zhvillimin e një turizmi afatgjatë dhe të qëndrueshëm por dhe për të shpëtuar planetin tonë. Në ditët tona, pothuajse të gjitha produktet janë të paketuara me plastikë, karton, qelq e alumin, të cilat për fat të mirë mund të riciklohen. Edhe mbetjet e tjera gjejnë vendin e tyre në mbledhjen e diferencuar: buka, perimet, frutat, mishi hidhen në depozitën e veçantë për prodhimet shumë të degradueshme. Duke diferencuar mbetjet e materialeve që mund të riciklohen kontribuojmë në shpëtimin e mjedisit dhe sillemi si qytetarë të përgjegjshëm.

Nevojat e konsumatorit në ditët e sotme janë në rritje të vazhdueshme dhe njerëzit, me vetëdije ose jo, po shtojnë gjithnjë e më shumë llojin e prodhimeve dhe të shërbimeve që ata përdorin. Tregu konsumator është i tejmbushur nga reklamat për produkte dhe shërbime të reja. Gradualisht, konsumi po bëhet pjesë shumë e rëndësishme e jetës së njerëzve.

Lënda e parë shndërrohet në mbetje si pasojë e proceseve të prodhimit dhe konsumit.

Tepricat e panevojshme të një produkti pasi konsumohet quhen mbetje. Mbetjet mund të shfrytëzohen përsëri, të përpunohen, të digjen në fabrika të veçanta ose të groposen në vend depozitime.

Reduktimi është mbrojtje aktive e mjedisit e cila ka të bëjë me minimizimin e disa prej mbeturinave që në burimin e krijimit apo të prodhimit të tyre. Reduktimi i mbetjeve do të thotë moslejimi i lindjes së mbeturinave. Kjo mund të realizohet nëse në jetën tonë të përditshme kemi synimet e mëposhtme:

- Blerje në mënyrë të ndërgjegjshme për mjedisin (kursimi i paketimeve);
- Prodhim i produkteve në shtëpi (p.sh. kosi);
- Zgjedhja e një paketime që mund të riciklohet;
- Kursimi i energjisë elektrike, i ujit, i kimikateve etj.;
- Mos hedhjen e artikujve të ndryshëm, që mund të përdoren për diçka tjetër;
- Zgjedhja e produkteve me sa më pak paketim;
- Reduktim i qeseve plastike, duke i zëvendësuar p.sh. me çantë pazari;
- Ripërdorim i enëve të kosit, të cilat mund të përdoren shumë mirë për vazo lulesh.

Ripërdorimi është procesi i grumbullimit dhe i ripërdorimit të disa mbetjeve, të cilat mund të hyjnë përsëri në qarkullim. P.sh.: shishe dhe kavanoza qelqi, që mund të grumbullohen dhe të ripërdoren; pjesë të materialeve inerte si: copa mermeri, copa tullash apo copa guri dekorativ, që mund të përdoren për dekorime të ndryshme në një objekt tjetër;

Riciklimi është procesi i ripërpunimit të mbetjeve duke dhënë një prodhim të ri. Gjatë riciklimit mund të ndryshojë struktura kimike e materialit, por bëhet i vlefshëm për një përdorim tjetër.

Veprimtaria 1: Ndërtojmë një kosh mbeturinash

Vështroni përreth dhe vlerësoni se cilat janë mbetjet që mund të riciklojmë? Duke përdorur kuti të vjetra, ndërtoni së bashku me nxënësit mbajtëse të mbeturinave të diferencuara dhe vendosini në mjedisin e shkollës tuaj.

Veprimtaria 2: 6 - Kapelet

Mësuesi prezanton çështjen (kapelën e kaltër): Turizmi në vendin tonë.

Ai ndan nxënësit në 5 grupe dhe i jep një detyrë secilit grup.

- *Kapelja e verdhë*: Cilat janë elementet pozitive të turizmit në vendin tonë?
- *Kapelja e zezë*: Cilat janë pengesat dhe anët negative të turizmit në Shqipëri?
- *Kapelja e gjelbër*: Çfarë mundësish dhe idesh të reja jepni për turizmin?
- *Kapelja e bardhë*: Cilat janë faktet dhe informacionet kryesore që dini rreth turizmit?

- *Kapelja e kuqe*: Çfarë pëlqimesh keni për vendet turistike në Shqipëri?

Pasi kanë punuar në grup, nxënësit prezantojnë punët e tyre. Në fund të veprimtarisë mësuesi bën konkluzionet e veprimtarisë.

Shënim: Tabela e mëposhtme sqaron se çfarë pritet nga secili grup.

	Kapela e bardhë kërkon informacionet e ditura ose të nevojshme. “Faktet, vetëm faktet.” <i>Lini argumentet dhe propozimet dhe shikoni bazën e të dhënave. Kjo mbulon faktet, shifrat, nevojat dhe mungesat e informacioneve. Shikoni informacionet që keni dhe shikoni çfarë mund të mësoni nga ato. Shikoni çka nuk dini dhe i plotësoni ose merrni parasysh.</i>
	Kapela e verdhë është simbol i pozitivitetit dhe optimizmit. Nën këtë kapelë ju eksploron gjërat pozitive dhe shikoni cilat janë vlerat dhe dobitë. <i>Kapela e verdhë ju ndihmon të mendoni pozitivisht. Është këndvështrimi optimist që ju ndihmon të shihni të gjitha përfitimet e vendimit dhe vlerën në të. Pse diçka do të funksionojë dhe pse do të sjellë përfitime. Mund të përdoret teksa presim rezultatet e disa veprimeve të propozuara, por mund të përdoret edhe për të gjetur diçka me vlerë në atë që tashmë ka ndodhur. Mendimi me kapelën e verdhë ju ndihmon të vazhdoni para kur gjërat duken të zymta dhe të vështira.</i>
	Kapela e zezë simbolizon gjykimin - avokatin e djallit ose shtjellon pse diçka mund të mos funksionojë. Vë në pah vështirësitë dhe rreziqet; ku gjërat mund të shkojnë keq. Ndoshta kjo është Kapela më e fuqishme dhe e dobishme në mesin e Kapelave por që paraqet problem nëse përdoret me tepri. <i>Duke përdorur kapelën e zezë për të menduar, shikoni të gjitha pikat e këqija të vendimit. Shikoni me kujdes dhe me vëmendje. Mundohuni të shihni pse mund të mos funksionojë. Kjo është e rëndësishme sepse thekson anët e dobëta të një plani. Ju mundëson t'i eliminoni, ndryshoni ato ose të përgatitni plane emergjente për to. Nuk ka kuptimin e një kapele inferiore ose negative. Kapela e zezë përdoret për të vërejtur se pse një sugjerim nuk përkon me faktet, përvojën e disponueshme, sistemin në përdorim ose politikën që ndiqet. Kapela e zezë duhet të jetë gjithmonë logjike. Mendimi nën kapelën e zezë ju ndihmon që planet tuaja të jenë 'më të fuqishme' dhe më të qëndrueshme. Mund</i>

	t'ju ndihmojë edhe të vëreni të metat fatale dhe risqet para se të filloni një veprim.
	Kapela e kuqe ka kuptimin e ndjenjave, parandjenjave dhe intuitës. Kur e përdorni këtë kapelë ju mund të shprehni emocione dhe ndjenja dhe të ndani frikën, pëlqimet, mospëlqimet, çka doni dhe urreni. <i>'Kur vini' kapelën e kuqe, ju i shikoni problemet duke përdorur intuitën tuaj, reagimin instinktiv dhe emocionet. Gjithashtu mundohuni të kuptoni si do të reagojnë emocionalisht të tjerët. Mundohuni të kuptoni përgjigjet e personave që nuk e njohin plotësisht arsyetimin tuaj. Kapela e kuqe i lejon mendimtarit të shprehë intuitë pa pasur nevojë ta arsyetojë atë. Zakonisht ndjenjat dhe intuita mund të futen në diskutim nëse mbështeten në logjikë. Nganjëherë ndodh që ndjenja është e vërtetë por logjika është e rremë. Kapela e kuqe i jep mendimtarit lejen e plotë për të shprehur ndjenjat e tij ose të saj për temën në atë moment.</i>
	Kapela e gjelbër fokusohet në kreativitet, mundësi, alternativa dhe ide të reja. Është mundësi për të shprehur koncepte dhe perceptime të reja.
	Kapela e kaltër përdoret për menaxhimin e procesit të të menduarit. Është mekanizmi kontrollues që siguron që udhëzimet e “gjashtë kapeleve” po vëzhgohen.

4.5. Aftësitë matematikore

Veprimtaria 1: Llogaritja e koston së një udhëtimi turistik

Llogaritja e koston së udhëtimit mund t'ju ndihmojë të planifikoni dhe të organizoni udhëtimin tuaj. Vlerësoni se çfarë ju duhet për një udhëtim si: kosto akomodimi, bileta transporti, kosto karburanti, kostot ushqimi dhe çdo shpenzim tjetër që mund të keni. Mblidhni të gjitha shpenzimet tuaja së bashku dhe mbajini të organizuara në mënyrë që të planifikoni shpenzimet dhe të llogaritni kostot tuaja. Ju gjithashtu mund të përdorni kërkimin në internet në faqen: www.viamichelin.com për të llogaritur distancën dhe koston e karburantit nëse do të udhëtoni me makinën tuaj. Po ashtu për të vlerësuar çmimet e fjetjes sipas buxhetit që keni, ju mund të përdorni kërkimin në internet në faqen: www.booking.com.

Së pari: Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë se cilat janë shpenzimet që i duhen atij për të organizuar pushime në një vend turistik.

Nr.	Artikulli	Çmimi në lekë për njësi	Sasia	Shuma
1.	Bileta vajtje e udhëtimit (karburanti)	2000	1	2000
2.	Akomodimi	5000		
3.	Ushqimi në ditë			
	Bilete vizite në muze			

Totali i shpenzimeve				

- Kryeni llogaritje të ndryshme sikur do të udhëtoni me një shok/shoqe ose me pjesëtarët e familjes. Nxënësit plotësojnë dhe llogarisin kostot sipas zërave të tabelës më sipër.

Këtë veprimtari mësuesi mund ta organizoni dhe në Excel.

Veprimtaria 2: Kostoja gjatë një udhëtimi

“Ju sapo jeni kthyer nga një udhëtimi një ditë me prindërit. Mamaja juaj kontrollon në portofolin e saj dhe pa se kishin tepruar dy kartmonedha 1000 lekëshe, një kartmonedhë 500 lekëshe, një kartmonedhë 200 lekëshe, tri monedha 50 lekëshe, një monedhë 20 lekëshe, një monedhë 10 lekëshe dhe 3 monedha 5 lekëshe. Ajo mbante mend se familja kishte shpenzuar dy herë para, gjatë udhëtimit. Ajo shpenzoi 1150 lekë në një market dhe disa para për ushqim. Kur ajo numëroi sasinë e parave në portofol, ajo kuptoi se kishte ekzaktësisht gjysmën e sasisë së lekëve që kishte në mëngjes. Llogarisni sa lekë shpenzoi familja juaj për ushqim gjatë udhëtimit? Llogarisni sa lekë kishte familja në fillim të udhëtimit?

Ju i thatë mamit se donit të blinit një top i cili kushtonte rreth 3000 lekë.

Diskutoni çfarë ju tha mamaja.

Shpreheni në formën e buxhetit dhe shpenzimeve të gjitha të dhënat.

Klasa ndahet në grupe me nga 4 persona. Në një fletë të madhe punohet me planifikimin e një buxheti. Si do ta shpenzonit ju këtë sasi parash

Grupi 1 10000 lekë

Grupi 2 15000 lekë

Grupi 3 20000 lekë

Grupi 4 25000 lekë

Po sikur t'ju duhet të planifikoni buxhetin për tre vitet e ardhme me të njëjtën sasi parash si do ta planifikonit buxhetin?

Prezantoni punën tuaj në secilin rast.

MODULI 5: Fatkeqësitë natyrore

Nr.	Njohuritë dhe aftësitë për modulin
5.1	Fatkeqësitë natyrore
5.2	Aftësitë e komunikimit
5.3	Aftësitë TIK
5.4	Aftësitë matematikore
5.5	Vullnetarizmi

Nëpërmjet veprimtarive praktike të paraqitura në modulin “Fatkeqësitë natyrore” nxënësi ndërton në mënyrë të integruar aftësitë bazë të komunikimit, të matematikës, digjitale, aftësitë e të menduarit kritik, aftësitë e zgjidhjes së problemit, aftësitë personale, qytetare, të orientimit për karrierë etj.

Rezultatet e të nxënësit

Nxënësi:

- ✓ dallon llojet e ndryshme të fatkeqësive natyrore;
- ✓ analizon rëndësinë që kanë fotot dhe ilustrimet në një tekst dhe shpreh opinionin e tij rreth tyre;
- ✓ zhvillon ndërgjegjen civile;
- ✓ kupton funksionet bazë të mbrojtjes civile;
- ✓ ndërgjegjësohet për punë vullnetare në komunitet
- ✓ përdor motorët e kërkimit në internet;
- ✓ krijon një fletëpalosje duke përdorur aftësitë TIK
- ✓ respekton rregullat e drejtëshkrimit
- ✓ merr pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tij;
- ✓ kryen veprime matematikore;

5.1 Fatkeqësitë natyrore

Informacion

Në planetin tonë ka rreziqe të shumta mjedisore që duhet të marrim parasysh pasi pasojat e tyre janë mjaft serioze. Bëhet fjalë për fatkeqësi natyrore. Ato zakonisht janë ngjarje që ndikojnë negativisht në jetën dhe qeniet njerëzore në një mënyrë të përgjithësuar dhe shkaktohen kryesisht nga fenomene që vijnë pa ndërhyrjen njerëzore. Në shumicën e rasteve, qenia njerëzore ka përgjegjësi për ndikimin e pasojave të praktikave të këqija, qoftë dhe nga planifikimi teknologjik i keq.

Disa nga llojet e katastrofave natyrore

- **Ortek:** është rënia e një mase të madhe dëbore me një terren të pjerrët për shkak të efektit të gravitetit. Nëse ndodh në zona të banuara nga qenie njerëzore, kjo mund të çojë në një katastrofë serioze.
- **Cikloni tropikal:** është stuhi rrotulluese me madhësi të madhe. Këto ciklone shoqërohen nga reshje të mëdha shiu dhe erëra me shpejtësi të lartë. Erërat mund të shkaktojnë shqetësime në det, përmbytje, shkatërrojnë infrastrukturën dhe madje mund të shkaktojnë vdekjen e njerëzve.
- **Rrëshqitjet tokësore:** është një lëvizje e ngjashme me një orte, por me masa tokësore të pjerrëta. Zakonisht ndodh për shkak të reshjeve intensive dhe të zgjatura që ngopin tokën me ujë dhe shkaktojnë rrëshqitje të dheut. Ato gjithashtu mund të ndodhin për shkak të ekzistencës së tërmeteve.
- **Epidemitë dhe pandemitë:** sëmundjet ngjitëse mund të shkaktojnë probleme serioze. Epidemitë përhapen nga infektimi dhe mund të shkaktojnë një pandemi.
- **Shpërthime vullkanike:** ato janë dëbime masive të magmës, hirit dhe gazrave që vijnë nga manteli i Tokës. Magma zhvendoset në një rrjedhë që zvarritet në të gjithë sipërfaqen e Tokës dhe djeg gjithçka në rrugën e saj.
- **Breshër:** stuhi të mëdha breshëri me reshje guri akulli 5-50 mm mund të ndikojnë dhe të shkaktojnë dëme të konsiderueshme.
- **Zjarret në pyje:** shumica e zjarreve janë të bëra nga njeriu, megjithëse shumë ndodhin natyrshëm. Kushtet ekstreme të thatësisë mund të ndezin spontanisht bimësinë më të thatë dhe të fillojnë zjarrin.
- **Përmbytjet:** ato ndodhin nga vërshimi i lumenjve dhe liqeneve të mëdha kur ka reshje të bollshme shiu. Mbulesa e gjatë mund të shkatërrojë infrastrukturën, të tërheqë kafshë dhe njerëz, të shkulë pemë, etj.
- **Thatësira:** është mungesa e shiut për një kohë të gjatë dhe si pasojë e temperaturës së lartë. Të korrrat humbin, kafshët vdesin dhe njerëzit detyrohen të largohen nga zona për shkak të urisë dhe etjes.
- **Tërmetet:** janë mjaft të frikshëm se janë të paparashikueshëm dhe mund të sjellin pasoja serioze. Mund të shembin një strukturë, të shkaktojnë shpërthime, të thyejnë tuba uji, diga dhe aksidente të tjera.
- **Tornadot:** është një zgjatim i resë që formon një kon të ajrit. Ato mund të shkatërrojnë infrastrukturën, të dëmtojnë rrugët e komunikimit dhe të kërcënojnë jetën e kafshëve dhe njerëzve.

- **Tsunami:** ato quhen edhe valë baticash. Ato shkaktohen nga ekzistenca e tërmeteve nënujore që shkaktojnë valë të mëdha që lëvizin me shpejtësi të lartë. Me ndikim në bregdet ato mund të prodhojnë fatkeqësi të mëdha për shkak të ndikimit dhe përmbytjes.

5.2 Aftësitë e komunikimit

Veprimtari 1: Koha për të folur

Mësuesi nis një diskutim mbi llojet e ndryshme të fatkeqësive natyrore. Nëse është e mundur të fillojë diskutimi me një tregim që zhvillohet në sfondin e një lufte, tërmeti apo zjarri. Çfarë janë këto dukuri? Pse ndodhin ato? Mësuesi mund të përdorë imazhe ose fotografi për të ilustruar qartë luftërat, përmbytjet apo tërmetet. Si vazhdon jeta e njerëzve pas këtyre fatkeqësive natyrore?





Mësuesi fton nxënësit të mendojnë dhe më pas të diskutojnë rreth sjelljeve të rrezikshme të njerëzve për situatat e mëposhtme:

- Ndërtojnë banesa buzë lumenjve
- Nuk marrin masa për mos përhapjen e viruseve

- Tregohen të kujdesshëm për të mos përdorur mjete që shkaktojnë zjarr
- Nuk marrin parasysh rregullat sizmike në ndërtimin e banesave
- Ndezin zjarre në pyje dhe në kodra sepse mendojnë që toka përtërihet në këtë mënyrë
- Ndjekin këshillat e sizmologëve në ndërtimin banesave
- Ndjekin rregullat e ndërtimit buzë lumenjve dhe deteve me distancën e duhur

Aktiviteti 2: Diskutojmë dhe plotësojmë në klasë

Mësuesi fton nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve më poshtë e me pas ju kërkon atyre të reflektojnë dhe të plotësojnë se cilat janë dëmet që mund të vijnë nga fatkeqësitë natyrore?

Pyetje për t'u diskutuar:

- Çfarë janë fatkeqësitë natyrore?
- Pse ndodhin ato?
- Cilat janë disa nga llojet e tyre?
- Çfarë masash marrim për secilin rast?
- Cilat janë numrat e telefonit që duhet të përdorim në rast emergjencash civile?

Shënoni:

Përmbytjet	Zjarret	Pandemia	Tërmetet

Shënoni nga një masë për mbrojtjen nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore:

Përmbytjet _____

Zjarret _____

Tërmetet _____

Pandemia _____

Mos harroni numrat e emergjencave:

NUMRAT E EMERGJENCAVE / SOS



5.3. Aftësitë TIK

Veprimtaria 1: Kolazh me fotografi

Kërkoni në internet dhe krijoni një kolazh me foto për të treguar fatkeqësitë natyrore si zjarret, përmbytjet, stuhitë, etj.

Veprimtaria 2:

Krijojeni fletëpalosje me programe të thjeshta kompjuteri për të informuar komunitetin në raste të fatkeqësive natyrore (*fletëpalosje informuese*).

Veprimtaria 3: Poster ose fletëpalosje

Mësuesi bashkë nxënësit nëpërmjet programeve në kompjuter ose me vizatime përgatisin një poster ose fletëpalosje që bën thirrje për pjesëmarrje në një aksion vullnetar.

Ajo/ai ndan punën për shkrimin e një slogani, përmbajtjes, vizatimet ose aplikimet, ngjitjen në mjediset e afërta me shkollën dhe shpërndarjen e posterit apo fletëpalosjes në familje të ndryshme.

5.4. Aftësitë matematikore

Veprimtaria 1: Llogaritja e kostos së një fustani

Jasmina duhet të blejë rreth 2 metra copë për të qepur një fustan dhe $\frac{1}{2}$ metër dantellë. Çmimi i copës është 2000 lekë për metër. Dantella kushton 3000 lekë metri. Jasmina ka gjithsej 5000 lekë.

- Llogarisni sa mund të blejë ajo: copë dhe dantellë?
- Nëse do të kishte 6000 sa mund të blinte ajo?
- Jasmina po bën të njëjtin fustan në një madhësi më të madhe. Ajo duhet të blejë saktësisht 3 metra copë dhe $\frac{1}{2}$ -metër dantellë. Çmimet janë po të njëjta. Jasmina ka gjithsej 7600 lekë.
- A ka ajo para të mjaftueshme për të blerë të dyja: edhe copat edhe dantellën.

Veprimtaria 3. Kostoja e këpucëve

Klajdi bleu 150 palë këpucë për 300 000 lekë. Ai shiti 100 prej tyre me 2500 lekë palën dhe e rriti çmimin. Mbas disa kohësh shiti edhe pjesën e mbetur me 2800 lekë palën. Sa lekë fitoi ai gjithsej?

A do të kishte fituar më shumë nëse do t'i kishte shitur të gjitha këpucët 2800 lekë?

A do t'i kishte shitur më shpejt nëse do të kishte mbajtur çmimin 2500 lekë?

Ç'mendoni ju ? Si do kishit vepruar ju ?

Veprimtaria 4. Kredia

Melisa ka marrë një kredi prej 2 000 000 lekësh. Ajo paguan 11 000 lekë në muaj. Kjo shumë mbulon vetëm interesin e huas së saj, prandaj ajo vazhdon t'i detyrohet bankës 2 000 000 lekë.

a) Si mendoni ju? Me sa interes e ma marrë ajo kredinë? (Sa është norma e interesit të thjeshtë vjetor?)

Pasi paguan për 20 vjet kështu mujore prej 11 000 lekësh, ajo e shlyen kredinë.

b) Si mendoni? Sa para ka paguar ajo në 20 vite?

c) Si mendoni ju? Sa përqindmë shumë ka paguar ajo krahasuar me shumën fillestare të marrë hua?

Veprimtaria 5. Çmimet

Çmimi i një televizori është ulur me 17% dhe tani kushton 75 200 lekë. Ju doni të blini një televizor. Sa ishte çmimi fillestar i televizorit? A do kërkonte ju të ulet çmimi? Sa mendoni të ulet?

5.5. Vullnetarizmi

Informacion

Vullnetarizmi ose puna vullnetare në përgjithësi konsiderohet një aktivitet altruist kur një individ apo grup ofron shërbime jo për përfitime financiare apo sociale “për një tjetër person, grup ose organizatë”. Puna vullnetare është gjithashtu e njohur për zhvillimin e

shkathtësive dhe shpesh ka për qëllim që të promovojë të mirat ose përmirësimin e cilësisë së jetës. Puna vullnetare mund të ketë përfitime pozitive si për vullnetarët, ashtu edhe për personin ose komunitetin e shërbyer.

Në fund të ditës puna vullnetare nuk është as me pak e as më shumë sesa një ndijim personal. Është një dëshirë për t'u ndjerë i përfshirë në komunitet, për t'u ndjerë i përfshirë në "veprime të mira", pra në akte të vogla humane që nuk bëjnë asgjë më shumë veçse ngrenë lartë shpirtin e njeriut. Gjithashtu puna vullnetare ma mëson sesa e vlefshme është jeta në bashkësi.

Aktivitetet vullnetare janë pasojë e një edukimi humanist, të njohur dhe të zbatuar në shekuj. Por në periudhat e fundit kohore, këto aktivitete duket se kanë humbur dhe një arsye është se ato nuk janë promovuar sa duhet nga institucionet e edukimit.

Veprimtaria 1: Lista e gjërave që duam të përmirësojmë

Mësuesi i ndan nxënësit në grupe duke i kërkuar secilit grup të bëjë një listë të gjërave që duhen përmirësuar në drejtimet e mëposhtme dhe duke nënvizuar me të gjelbër atë që mund të bëjnë vullnetarët dhe me të kuqe atë që duhet ta bëjë shteti me institucionet e tij.:

- Mjedis
- Shëndet
- Arsimit
- Punë sociale
- Kulturë (trashëgimi)

Udhëzohen nxënësit që lista të përmbajë gjëra konkrete që ata i vlerësojnë se nuk janë mirë. P.sh. në mjedis - parqet e ndotura, në shëndetësi - të sëmurët në shtëpi, pa ndihmë, në arsim - bankat e klasës të shkatërruara, në punë sociale - njerëz në nevojë, në kulturë - objekte të trashëgimisë të dëmtuara, etj.

Pas përgjigjeve të përfaqësuesve të secilit grup, diskutohet për punët vullnetare që mund të kryejë një komunitet.

Më pas mësuesi kalon në rubrikën e diskutimit duke paraqitur disa foto dhe pamje filmike nga veprime vullnetare që njerëzit bëjnë në raste fatkeqësish natyrore, në rastet e ndihmës për njerëzit në nevojë, në riparimin e një situatë të vështirë, etj. Më pas, u drejtohen nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë është puna vullnetare?
- Cilat janë disa nga punët vullnetare që bëjnë ose mund të bëjnë anëtarët e komunitetit tuaj?
- Cilat janë disa punë vullnetare që bëjmë ose mund të bëjmë ne si nxënës?

– Tregoni se ç'ndjenja provon çdo njeri kur ndihmon të tjerët vullnetarisht?

Veprimtaria 2: Kryeni një pastrim publik

Pastrimi i hapësirës publike është një aktivitet i mrekullueshëm vullnetar për nxënësit që duan të nxisin nisma mjedisore. Ju mund të organizoni një pastrim në një park lokal, pyll, rrugë ose plazh me nxënësit. Ky aktivitet ju lejon të kontribuoni në reduktimin e ndotjes dhe për ta bërë zonën tuaj të duket më miqësore dhe e sigurt. Gjithashtu për këtë aktivitet nxënësit përgatisin një poster ose fletëpalosje që bën thirrje për pjesëmarrje në një aksion vullnetar.

Paketimet e ëmbëlsirave, bishtat e cigareve dhe mbeturinat e tjera shpesh mbushin rrugët dhe parqet në zonën tuaj. Ju mund të organizoni pastrime të shpeshta për të mbajtur nën kontroll këtë dhimbje të syve.

Veprimtaria 3: Mblidhni dhe dhuroni ushqim për kafshët shtëpiake

Nxënësit mund të marrin pjesë në një sfidë një javore për të mbledhur dhe shpërndarë sa më shumë ushqim për kafshët që të jetë e mundur. Ky aktivitet është një nga mundësitë më të zakonshme vullnetare për grupe të vogla. Procesi mund të jetë i këndshëm dhe miqtë tuaj me gëzof në nevojë do të përfitojnë nga bujaria juaj.

Nëse do të doni të mblidhni ushqim për kafshët shtëpiake, atëherë vizitoni bizneset e kafshëve shtëpiake në lagjen tuaj, vendosni postera në lagjen ose pranë shkollës suaj dhe kërkoni donacione nga familja dhe miqtë. Ju gjithashtu mund të organizoni një "Pet Wash" (larje e kafshëve), ku mund të ftoni dhe një veteriner të zonës ose shkollës suaj që t'ju ndihmojë t'i pastroni ato. Pasi të përfundoni aktivitetet mund të vizitoni strehën lokale të kafshëve nëse ka ose të përdorni video të ndryshme për t'i parë këto streha.

Veprimtaria 4: Sfidoni veten për të qenë të gjelbër

Me një sfidë eko-miqësore, mund të inkurajohen nxënësit të bëjnë pjesën e tyre për të ndihmuar mjedisin. Kjo sfidë është e mirë për rritjen e ndërgjegjësimit se si rutinat e përditshme shkaktojnë shqetësimet "e gjelbërta" si uji, mbeturinat, energjia dhe shëndeti. Kjo sfidë mund të zgjasë rreth një muaj dhe përfshin objektivin që nxënësit dhe stafi mësimdhënës të përdorin biçikletën për të ardhur në shkollë përgjatë atij muaji. Gjithashtu promovoni brenda ambienteve të shkollës që të gjithë të përdorimin materiale të riciklueshme si çanta ushqimore pëlhure. Gjatë kësaj kohe të mbahet një kalendar se sa individë kanë ardhur me biçikletë gjatë atij muaji dhe në fund të bëhet një përmbledhje.

Në përfundim të këtij aktiviteti, të gjithë do të ketë mësuar dhe praktikuar se si të jetojë në mënyrë më të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

Veprimtaria 5: Diskutoni në klasë

- Sa përdoret biçikleta si mjet transporti në qytetin ose fshatin tuaj?
- A keni biçikleta në shtëpi? A e përdor ndonjë nga prindërit tuaj atë? Çfarë thotë për udhëtimin me të?

Informacion

Bota ka ndryshuar kaq shumë, si rezultat i përdorimit të makinave, sa që sot pak njerëz e dinë që ecja me këmbë apo me biçikletë është forma kryesore e lëvizjes së njerëzve.

Tridhjetë vjet më parë, prodhuesit e automobilave parashikuan se makinat do t'i zëvendësonin biçikletat, duke u bërë kështu forma kryesore e transportit personal, por po ndodh e kundërta. Sot ka rreth dy herë më shumë biçikleta, sesa makina dhe çdo vit prodhohen tri herë më shumë biçikleta se makina. Vetëm në Azi, biçikletat transportojnë më shumë njerëz sesa të gjitha makinat në të gjithë botën.

Që në fillim të viteve 1970, në Danimarkë, Francë, Gjermani, Suedi dhe Holandë është nxitur dhe është përkrahur lëvizja me biçikletë në qytet. Sot 33 % e danezëve parapëlqejnë biçikletën si mjet transporti. Numri i njerëzve që lëvizin me biçikletë në qytete të tilla si Odensë dhe Kopenhagën (Danimarkë), Bazel (Zvicër) dhe Hanovër (Gjermani) përbën 25- 30% të popullsisë së këtyre qyteteve.

Për sa i përket trafikut të zonave urbane, makinat dhe biçikletat lëvizin pothuaj me të njëjtën shpejtësi mesatare. Nëse njerëzit që lëvizin me biçikletë përdorin rrugë të përcaktuara për biçikleta, ata mund të ecin më shpejt se një makinë për distanca më të vogla se 10 kilometra.

Biçikleta

Nga të gjitha shpikjet që janë bërë deri tani, biçikleta është një prej më të mrekullueshmeve prej tyre. Të ngasësh një biçikletë nuk të duhet asgjë, përveç pak muskuj. Të mësosh ta ngasësh është e thjeshtë.

Biçikleta është e shpejtë, sportive, elegante dhe e lehtë për ta riparuar. Ndër të tjera është një mjet transporti fantastik dhe bën mirë për shëndetin. Nuk ndot mjedisin.

Në qytetet e mëdha ku ka një trafik shumë intensiv, për të shkuar diku shkon më shpejt me biçikletë se sa me makinë. Dhe më pas nuk të duhen xhiro të tëra për të kërkuar një parking.

Një biçikletë e re mund të kushtojë jashtëzakonisht shumë. Ekzistojnë biçikleta me shumë pajisje të cilat masin një sërë gjërash në mënyrë të kompjuterizuar, Një biçikletë e tillë mund të tregojë se ku je, si mund ta bësh rrugën që të pret dhe si quhet vendi nëpër të cilin do të kalosh. Por këto nuk janë gjëra që i duhen një përdoruesi të thjeshtë. Për të bërë një biçikletë të funksionojë duhen dy rrota, një timon, ndriçim dhe frena. Sa i aftë, i sigurt dhe i shpejtë është

një person në biçikletë, kjo varet prej tij dhe jo prej pajisjeve shitesë që një shitës reklamon për blerjen e saj.

Të dimë më shumë

Po të vëzhgosh një biçikletë të personave që e përdorin vazhdimisht siç janë çiklistët apo postierët vëren se ato kanë vetëm gjërat esenciale dhe janë të lehta dhe të sigurta në përdorim. Por ata dinë t'i kontrollojnë mjetet e tyre. Ata dinë të frenojnë ashtu siç duhet. Mund të ngrenë rrotën e përparme dhe të ecin vetëm me atë të pasmen. Biçikleta është pjesë e tyre, sikurse mund të jetë një dorezë leshi. Ata janë në gjendje të bëjnë çfarë do lloj akrobacie.

Veprimtaria 6: Shëtitje me biçikletë

Mësuesi organizon me nxënësit një shëtitje me biçikletë në një nga parqet, zonat turistike të qytetit, duke respektuar sinjalistikën e lëvizjes me biçikletë.

Mësuesi së bashku me nxënësit, por edhe duke ftuar ndonjë prind që ka mundësinë e kohës në dispozicion, organizon një ekskursion me biçikleta në zonën më të afërt, të përshtatshme për të bërë një shëtitje të tillë. Së bashku me nxënësit ai vëren dhe përshkruan ndryshimet që mund të bëhen në rrugët e qytetit për ta bërë ecjen me biçikletë më të sigurt dhe më praktike.

Gjatë pushimit nxënësit reflektojnë dhe diskutojnë:

- Të shprehin ndjenjat dhe emocionet që provojnë kur ecin me biçikletë
- Të bëjnë një shëtitje të organizuar me biçikletë jashtë qytetit
- Të tregojnë përparësitë e ecjes me biçikletë.
- Të tregojnë se kur është e vështirë ecja me biçikletë?
- Të tregojnë nëse janë të përshtatshme rrugët e komunitetit të tyre për ecjen me biçikletë dhe çfarë duhet bërë për të ardhmen?
- Të diskutojnë se pse biçikleta është miqësore me mjedisin?

Veprimtaria 7: Lepuri dhe breshka

Mësuesi së bashku me nxënësit dalin jashtë klase dhe organizojnë garën “Lepuri dhe breshka”. Ajo/ai u kërkon disa vullnetarëve që të bëhen pjesë e lojës. Disa prej tyre do të ecin me këmbë, me shpejtësi normale drejt një vendi të caktuar. Grupi tjetër do të ecë drejt të njëjtit vend me biçikleta. Gjeni sa herë mund ta bëjnë ata që ecin me biçikletë distancën deri te vendi i përcaktuar në krahasim me ata që ecin me këmbë për të mbërritur atje. Cili grup është lepur i dhe cili është breshka?

MODULI 6: Arte

Nr.	Njohuritë dhe aftësitë për modulin
6.1	Arte
6.2	Aftësitë e komunikimit
6.3	Aftësitë TIK
6.4	Aftësitë matematikore
6.5	Vendosja e një qëlimi dhe bashkëpunimi

Nëpërmjet veprimtarive praktike të paraqitura në modulin “Arte” nxënësi ndërton në mënyrë të integruar aftësitë bazë të komunikimit, të matematikës, digjitale, aftësitë e të menduarit kritik, aftësitë e zgjidhjes së problemit, aftësitë personale, qytetare, të orientimit për karrierë etj.

Rezultatet e të nxënës

Nxënësi:

- ✓ mëson të vendos qëllime për shkollimin, hobit dhe karrierën e tij;
- ✓ zbulon se si sjelljet dhe qëndrimet ndikojnë në situatat e shkollës, punës dhe familjes;
- ✓ vlerëson rëndësinë e të punuarit në çift ose në grup
- ✓ zhvillon aftësi për të ndërtuar marrëdhënie pozitive në jetë;
- ✓ demonstroi aftësi dhe qëndrime ndaj të mësuarit;
- ✓ përdor motorët e kërkimit për të mbledhur informacione nga një shumëllojshmëri burimesh të sigurt në internet dhe për zgjedh materialin në përshtatje me qëllimin e kërkimit;
- ✓ krijon ndërmjet programit Power Point kuice interaktive;
- ✓ tregon përmbajtjen e tekstit, duke e ilustruar me detaje nga teksti;
- ✓ krahason personazhet kryesore, duke e ilustruar përgjigjen me detaje nga teksti;
- ✓ interpreton pjesë nga teksti, duke shprehur mendimin e tij;
- ✓ kryen veprime matematikore;
- ✓ merr pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tij;

6.1. Arte

Informacion

Historia e arteve përfshin çdo aktivitet ose produkt të krijuar nga njeriu për qëllime komunikuese që shprehin ide, emocione ose një vizion të botës. Arti përdor metoda të ndryshme, të tilla si plastike, gjuhësore, sonore apo të përziera. Historia e arteve si një disiplinë akademike si dhe mjedisi e kanë zakon ta kufizojnë atë në të ashtuquajturat arte pamore ose plastike ndërkohë që artet e tjera studiohen në mënyrë më specifike nga disiplina të tjera, të

përcaktuara qartë, si historia e letërsisë apo historia e muzikës, duke qenë të gjitha objekt vëmendjeje nga e historia e kulturës , historia e filozofisë apo historia e religjioneve. Disa fusha të dijes të lidhura ngushtësisht me historinë e artit, janë estetika dhe teoria e artit. Përgjatë kohës arti ka qenë klasifikuar në mënyra të ndryshme, që nga ai mesjetar e deri tek artet liberale dhe artet mekanike.

Sot në klasifikimin në arte të bukura dhe arte të aplikuara, përcaktimet bashkëkohore e shohin artin si një shfaqje e kreativitetit njerëzor.

Sot, arti gëzon një rrjet të gjerë studimi, përhapjeje dhe konservimi të gjithë trashëgimisë artistike të njeriut përgjatë historisë. Ngritja e medieve ka qenë themelore në përmirësimin e studimit dhe përhapjes së artit. Çmime si ai Turner i Tate Gallery-së, Wolf Prize in Arts, Pritzker Prize i arkitekturës, Pulitzer i fotografisë dhe ai Oscar i kinematografisë promovojnë gjithashtu punët më të mira krijuese në nivel ndërkombëtar.

Veprimtaria 1: Reflektoni dhe diskutoni!

Mësuesi kalon në rubrikën e diskutimit duke paraqitur disa foto dhe pamje filmike nga llojet e ndryshme të arteve në Shqipëri, veprave më të njohura të artit. Më pas, iu drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë llojet e arteve që pëlqeni më shumë?
- Cilët janë disa nga veprat që njihni dhe i keni parë në faqet e librave apo në internet?
- Cilët janë disa nga artistët më të shquar të Shqipërisë dhe sot?
- Cilët prej artistëve shqiptarë janë të njohur në të gjithë botën?

Veprimtaria 2: Vizitë në një galeri arti ose studio arti

Pasi kanë folur për llojet e ndryshme të artit, mësuesi së bashku me nxënësit përzgjedh vizitë në galerinë e arteve ose në ekspozitë pikturë. Po ashtu au i jep nxënësve si alternativa përzgjedhjeje edhe një studio piktori, skulptori apo fotografi të zonës ku jetojnë. Ky aktivitet i njeh nxënësit konkretisht me procesin e krijimit dhe punës për një vepër artistike.

Përpara vizitës në një nga mjediset e përmendura më lart, mësuesi së bashku me nxënësit ka përgatitur një listë pyetjesh për artistin:

- Kur e keni bërë pikturën, skulpturën apo fotografinë e parë?
- Cilat janë objektet që të sjellin më shumë frymëzim?
- Si lind dhe si punohet për një vepër artistike?
- Çfarë provon kur i ekspozon punime e tua?
- A të pëlqejnë të gjitha punët njëlloj apo disa i do më shumë?
- Po publikut tënd?
- A ke një faqe në internet dhe çfarë të shkruajnë fansat e tu, etj.?

Mësimdhënësi së bashku me nxënësit mund të mbyllin vizitën e tyre duke bërë një foto me artistin.

Veprimtaria 3: Shohim së bashku një film në kinema

Shikimi i filmave së bashku është një aktivitet mjaft i dobishëm dhe i vlerësuar për fëmijët. Ata, pas shfaqjes së tij mund të shfaqin ndjenjat dhe emocionet e tyre duke ndarë njëkohësisht edhe komentet që kanë për filmin. Të mësuarit vizual është mjaft efektiv dhe tërheqës për fëmijët. Më pas diskutohet:

Pyetjet e bëra mund të jenë:

- Cili ishte momenti më i bukur i filmit?
- Cili ishte personazhi kryesor dhe a ju pëlqeu loja e tij?
- A ishte përzgjedhur si duhet mjedisi i xhirimit?
- Cili nga personazhet ju pëlqeu më shumë në interpretim?
- Si do të ndryshonit skenarin e filmit?

Veprimtaria 4: Vizatim në grup

Ngjitni një copë të madhe letre në një mur bosh në klasë dhe jepini secilit nxënës shkumësa me ngjyra ose lapsa me ngjyra. Mësuesi u shpjegon se ky është një aktivitet për të vizatuar në grup dhe secili prej nxënësve duhet të japë kontributin e saj/tij. Së bashku me nxënësit zgjidhni temën e vizatimit, e cila mund të jetë një kafshë ose një vend imagjinar. Kërkojini një nxënës të vizatojë një rreth, i cili do të jetë trupi i kafshës. Dërgoni një nxënës tjetër për të vizatuar këmbët e kafshës. Nxënësit me radhë vizatojnë pjesë të trupit ose detaje mbi kafshën. Tregojuni nxënësve se ata gjithashtu mund të shtojnë një sfond dhe elementë të tjerë në vizatim. Gjithashtu kjo mund të organizohet në mënyrë që të gjithë nxënësit të vizatojnë në të njëjtën kohë dhe ju mund të vëzhgoni dinamikën e grupit dhe mënyrën se si ata lidhen me njëri-tjetrin. Kjo detyrë ju lejon gjithashtu të përcaktoni pikat e forta të secilit nxënës. Më pas diskutoni në lidhje me këtë aktivitet.

Veprimtaria 5: “Gjueti” në natyrë

Mësoni për natyrën dhe fotografinë nëpërmjet një gjueti argëtuese e cila do t'i bëjë fëmijët të identifikojnë pemët, kafshët, lulet dhe më shumë. Shkruani një listë me 10 gjëra që nxënësit mund të gjejë jashtë në një park apo rreth mjediseve të shkollës. Më pas, jepuni atyre një telefon ose një aparat fotografik ku gjithësecili të bëjë një fotografi. Kur të mbaroni, do të keni një koleksion të të gjithë nxënësve, që ata kanë bërë në natyrë si dhe mund të bëni diskutime të shumta për këtë aktivitet.

Veprimtaria 5: Vizatim për pesë minuta

Mësoni rreth nxënësve tuaj duke u dhënë atyre një detyrë pesë minuta ku secili prej tyre duhet të skicojnë një objekt ose kafshë që i përcakton ata. Kërkojini secilit nxënës të dalë përpara klasës dhe të shpjegojë vizatimin e tij dhe pse zgjodhi objektin ose kafshën. Mund të përdorni gjithashtu një video projektor i cili mund të zmadhojë secilën skicë, në mënyrë që të gjithë në klasë ta shohin vizatimin. Kërkojuni klasës t'i bëjë pyetje secilit nxënës gjatë prezantimit. Kjo veprimtari ju lejon të vlerësoni aftësitë e vizatimit të secilit nxënës dhe i ndihmon ata të mësojnë për njëri-tjetrin.

6.2. Aftësit e komunikimit

Harry Potter

Harri Poteri është një djalë jetim i cili jeton me tezen e tij, [Petunia Dërsli](#), të shoqin e saj, [Vernon Dërsli](#) dhe djalin e tyre, [Dadli Dërsli](#). Në moshën 11 vjeçare, Harri zbulon se është magjistar megjithëse jeton në botën e zakonshme të njerëzve jo-magjistarë, të quajtur Babanacë. Bota e magjistarëve ekziston paralelisht me botën e Babanacëve megjithëse e fshehur prej saj. Aftësia e tij është e lindur dhe fëmijë të tillë janë të ftuar të ndjekin një shkollë të veçantë magjie që i mëson aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në botën e magjistarëve. Ndërsa Harri përjeton adoleshencën e tij, ai mëson të kapërcejë problemet me të cilat përballet, magjike, sociale dhe emocionale, duke përfshirë sfida të zakonshme të adoleshentëve si miqësitë, pasionet, marrëdhëniet romantike, provimet, ankthin, stresin e depresionin si dhe sfidën më të madhe për të përgatitur veten për botën që e pret përpara në Britaninë që po priret gjithmonë e më shumë drejt luftës së dytë të magjistarëve.

Ishte një e shtunë plot me diell dhe kopshti zoologjik gëlonte nga familjet. Te dera e hyrjes së Dërslit, xhaxha Vernoni i bleu Dadlit dhe Persit dy akullore të mëdha me çokollatë dhe pastaj, meqë banakierja buzëgaze e shitores e pyeti Harrin ç' dëshironte të merrte, para se ata të dy ta largonin së andejmi, i bleu një lëng limoni të ngrirë, që kushtonte pak. "S'ka të sharë", mendoi Harri duke e lëpirë, tek po shikonte një gorillë që po kruante kokën dhe që i ngjiste tepër fort Dadlit, veçse nuk ishte flokëverdhë.

Ajo që paraditja më e bukur që kishte kaluar Harri prej shumë kohësh. U përkujdes që të ecte ndonjë hap më mbrapa, në mënyrë që Dadli dhe Persi, të cilët në kohën e darkës kishin filluar të mërzhiteshin nga kafshët, të mos ia nisnin përsëri argëtimit më të dashur të tyre e ta zinin me grushte. Hëngrën darkë në restorantin e kopshtit zoologjik dhe, kur Dadli bëri naze, sepse feta e tij e ëmbëlsirës nuk ishte mjaft e madhe, xhaxha Vernoni i bleu një tjetër dhe Harrit i dhanë

leje ta mbaronte atë që la tjetri. Më vonë Harri mendoi se duhej ta kishte kuptuar që në fillim se tërë ajo mirësi s'kishte si të zgjaste.

Pas buke shkuan në ndërtesën ku mbaheshin gjarpërinjtë. Lokali ishte i freskët dhe gjysmë i errët, me vitrina të ndriçuara përgjatë faqeve të mureve. Përmbas xhamave, zhapinj dhe gjarpërinj të të gjitha llojeve zvarriteshin dhe ngjiteshin nëpër trungje pemësh dhe nëpër gurë. Dadli dhe Persi donin të shikonin kobrat e stërmëdha dhe helmuese, si dhe pitonët trupmëdhenj që mund të zgërlaqnin njeriun. Dadli u tregua më i shkathët dhe e diktoi ku ishte gjarpri më i madh nga të gjithë të tjerët. Ai mund të mbështillej për bukuri dy herë rreth makinës së xhaxha Vernonit dhe ta shtrydhte e ta bënte sa një kazan plehrash, por në ato çaste sikur s'ishte në qejf. Përkundrazi, ishte duke bërë një gjumë të thellë. Dadli mbeti me hundë të ngjeshur pas xhamit, duke soditur dredhat e murrme e të shkëlqyera. – Bëje të lëvizë, – i tha të atit me zë qaramani. Xhaxha Vernoni trokiti më fort me noçkat e gishtave, por gjarpri s'u tund. “Dreq o punë!” – tha Dadli duke u ankuar dhe iku me vrap. Harri u ngul përpara vitrinës së pitonit dhe e vështroi gjarpurin me ngulm. Nuk do të habitej fare sikur edhe ai të vdiste nga mërzia, pa pasur shoqëri tjetër, përveç atyre vetëve që trokitnin tërë ditën mbi xham, duke u përpjekur ta shqetësonin. Ishte ku e ku më keq sesa të kishe për dhomë gjumi një zgëqe, ku i vetmi njeri që vinte ishte teta Petunia, e cila trokiste fort në derë për të të zgjuar; ai, të paktën, mund të bridhte nëpër tërë shtëpinë.

Papritur gjarpri i hapi sytë e vegjël dhe të ndritshëm.

Ngadalë, shumë ngadalë ngriti paksa kokën, deri në lartësinë e kokës së Harrit. Harri e shikoi i habitur. Pastaj hodhi sytë rreth e qark për të parë se mos i shihte kush. Askush. Filloi ta shikonte përsëri ngulmas, kësaj radhe ia shkeli syrin.

Veprimtari 1: Teksti për vete

Pasi nxënësit kanë lexuar fragmentin e mësipërm, u kërkohet nxënësve që të thonë shkurtimisht përmbajtjen e tekstit. Një nxënës thotë përmbajtjen e tekstit, ndërsa nxënësit e tjerë plotësojnë në fund, detajet e tekstit që nuk jepen nga shoku i tyre.

Veprimtari 2: Diagrami i Venit

Mësuesi u kërkoi nxënësve që të ndërtojnë një Diagram të Venit në lidhje me dy personazhet e tekstit të mësipërm: Harrit dhe Dadlit:

- Harry është i qetë, ndërsa Dadli është grindavec.
- Harri është i heshtur, ndërsa Dadli është llafazan.
- Ndryshimet në pamjen e jashtme.
- Etj.

Nxënësit i shkruajnë ndryshimet dhe ngjashmëritë në diagram (në një fletë). Ngjashmëritë në pjesën që priten rrathët, ndësa ndryshimet në dy pjesët e tjera. Të gjitha përgjigjet e nxënësve, ilustrohen me detaje nga fragmenti.

6.3. Aftësitë TIK

Veprimtaria 1. Kërkimi i informacionit ndërmjet motorëve të kërkimit.

Mësuesi i ofron nxënësve njohuri praktike lidhur me përdorimin e motorëve të kërkimit duke dhënë sugjerime se si nxënësit mund të përmirësojnë procesin e kërkimit të informacionit ndërmjet cilësimeve të ndryshme që ata mund të vendosin. Gjithashtu nxënësit përvetësojnë dhe praktikojnë njohuri në krijimin e prezantimeve multimediale duke marrë në konsideratë qëllimin e prezantimit, audiencën dhe parimet e dizenjimit.

Mësuesi i fton nxënësit të kërkojnë në internet informacione lidhur me personazhin e tyre të preferuar dhe më pas i pyet ata për kriteret që zgjedhin në selektimin e ëeb faqeve nga të cilat sigurojnë informacionin.

- Mësuesi i orienton nxënësit të përdorin motorë të ndryshëm kërkimi për të njëjtin objektiv si dhe nxit diskutime lidhur me mënyrën e shfaqjes së rezultateve të kërkimit.
- Për të shtuar interaktivitetin me nxënësit, sugjerojuni atyre të kërkojnë në Google , disa kërkime zbavitëse të listuara si mëposhtë:
 - Do a barrel roll
 - Atari Breakout
 - Askeë
 - Google Gravity
 - Roll a dice
 - Google pacman

Veprimtaria 2. Krijimi i një prezantimi ndërmjet programit PoëerPoint

Kjo veprimtari synon të gërshetojë përforcimin e njohurive të nxënësve për kërkimin e informacionit në internet me krijimin e prezantimeve digjitale të pasuruara me elementë të ndryshëm multimedialë.

- Mësuesi fton nxënësit të hapin programin PoëerPoint dhe të përzgjedhin një tematikë për prezantimin që do të krijojnë.
- Bazuar në kërkimet në internet nxënësit paraqesin informacionet e sintetizuara në PoëerPoint, duke insertuar tekst, imazhe, grafikë, cliparts apo elementë të tjerë vizualë.

6.4. Aftësitë matematikore

Veprimtaria 1: Llogaritja e ujit të shpenzuar

Mësuesi diskuton me nxënësit:

- Si e shpenzoni ujin në shtëpi?
- A e kurseni ujin në shtëpi?
- Diskutoni rreth mundësisë të kursimit të ujit kur i lajmë dhëmbët. *(Ai që lan dhëmbët duhet ta hapi çezmën e ujin vetëm kur duhet të lagë furçën ose dhëmbët, ndërsa e mbyll gjatë kohës kur i pastron dhëmbët me furçë.)*

Tregojuni nxënësve se përshtypja e parë është se kjo mënyrë e kursimit nuk ka efekt të rëndësishëm gjatë kursimit të ujit. Mes të tjerash, në realitet, nëse secili e bën këtë ndryshim të vogël mund të ketë një efekt shumë të madh. Që t'i bindni ata që dyshojnë ftoni nxënësit që ta zgjedhin problemin në vijim:

Përfytyro sikur secili anëtar i familjes do t'i lajë dhëmbët me ujin që rrjedh tërë kohën. Kur t'ju tregoni se të gjithë mund të kursejnë ujë, ata binden që t'i ndryshojnë mënyrën e tyre dhe ta përdorin ujin vetëm kur do të duhet të lagin furçën dhe shpëlajnë dhëmbët.

Eksperimenti përfshin të dhënat në vijim:

- Familja juaj përbëhet nga 5 anëtarë të familjes.
- Çdo anëtar i lan dhëmbët dy herë në ditë.
- Pastrimi i dhëmbëve përafërsisht zgjat rreth 3 minuta, ndërsa rrjedha mesatare e ujit është 2 litra në minutë.
- Me metodën e kursimit të ujit kursehet 1 litër për person.
- Ftoni nxënësit që në çifte të llogarisin:
 - a. Sasinë e ujit që e përdor familja kur e lë ujin që të rrjedhë vazhdimisht.
 - b. Sasinë e ujit që e përdor familja kur e zbaton mënyrën për kursim.
 - c. Sasinë e ujit që mund të kursehet për një ditë nga familja.
 - d. Çfarë mund të ndodhë nëse njëqind familje të qytetit tuaj e ndjekin këtë shembull?

Përgjigje:

A) $3 \times 2 \times 2 \times 5 = 60$ litra në ditë

Shpjegojuni nxënësve se nëse respektohet kjo një vit, rezultati do të jetë:

$$60 \times 365 = 21.900 \text{ litra}$$

B) $1 \times 2 \times 5 = 10$ litra në ditë

Shpjegojuni nxënësve se nëse respektohet kjo një vit, rezultati do të jetë:

$$10 \times 365 = 3.650 \text{ litra}$$

C) 60 litra - 10 litra = 50 litra në ditë

Së bashku llogariteni ujin e kursyer të familjes për një vit (18.250 litra). për lehtësim, rrethoni shifrën prej 20.000 litra ose 20 metra kub për familje.

D) 50 litra x 100 = 5.000 litra në ditë

Së bashku llogariteni ujin e kursyer të 100 familjeve për një vit - 1.825.000 litra (1.825 metra kub) ose nëse e keni zgjedhur që të rrumbullakoni - rreth 2.000 metra kub.

Sqarojuni se me 2.000 metra kub mund të mbushni një pishinë të madhe si pishina e olimpiadës (50 m x 20 m x 2 m).

6.5. Vendosja e një qëllimi

Veprimtaria 1: Ecim dhe diskutojmë

Mësuesi formon grupe të vogla prej dy deri në katër persona. Mësuesi kërkon që pjesëtarët e grupeve të ecin në oborr 2 deri në 5 minuta dhe të ndajnë me njëri -tjerin përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme:

- Çfarë është e mirë dhe ju pëlqen më shumë në jetën tuaj?
- Çfarë nuk është e mirë dhe nuk ju pëlqen në jetën tuaj?
- Çfarë qëllimi synoni të arrini?



sëbashku përgjigjet.

Mësuesi e ndan tabelën në tre pjesë ku në secilën pjesë shkruan pyetjet e mësipërme.

Më pas mësuesi i fton nxënësit të shkojnë në klasë dhe të shkruajnë në shirita përgjigjet sipas pyetjeve që diskutuan më sipër.

Këto shirita i ngjisin secili në mur të grupuara sipas çdo pyetje dhe diskutojnë

Veprimtaria 2: Plotësoj fletën e punës “Vendosja e qëllimeve për ti arritur ato”

Emri im _____

Qëllimi im është:



Data kur do ta arrij është:



Për të arritur qëllimin tim unë duhet të bëj 3 gjëra:

- 1.
- 2.
- 3.

Unë do të di se e kam arritur qëllimin tim sepse:

Dy gjëra që do të më ndihmojnë të qëndroj në arritjen e qëllimit tim janë:

- 1.
- 2.

Veprimtaria 3: Plotësoj fletën e punës “Plani im i karrierës”

Mësuesi fton nënësit të plotësojnë fletën e punës më poshtë “Plani im i karrierës” dhe i diskutojnë ato së bashku:

Arritja ime më e madhe:	
Gjërat që më pëlqen të bëj pas shkollës:	
Lëndët e mia shkollore më pëlqejnë:	
Lëndët e mia shkollore nuk më pëlqejnë:	
Dy aktivitetet e mia të preferuara të kohës së lirë:	
Dy zgjedhjet e mia të mundshme të karrierës:	

Ku jam unë tani? _____

Çfarë arrita vitin e kaluar në shkollë?

☛ **KUJDES** – Jini pozitiv. Jepini vetes një mundësi për të arritur edhe pjesë të një qëllimi ose arritje që nuk e kishit planifikuar.

Çfarë arrita vitin e kaluar në komunitet ose në shtëpi?

☛ **KUJDES** – Mos harroni se arritjet e vogla mund të ndihmojnë në arritjen e qëllimit final.

Cilat janë qëllimet e mia aktuale arsimore?

☛ **KUJDES** – Qëllimet tuaja mund të jenë suksesi në një lëndë, të jeni në një ekip sportiv ose të flisni më pak në klasë. Sigurohuni që mund matni, vlerësoni dhe të arrini në kohë qëllimet tuaja.

Cilat janë afatet e synuara?

☛ **KUJDES** – Ju mund të dëshironi të keni synime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Vendosni data të synuara realiste. Sigurohuni që të jepni kohë të mjaftueshme për të arritur qëllimet tuaja.

Cilat janë përfitimet e arritjes së qëllimeve të mia? Çfarë aftësish, arsimimi do të më duhen për zgjedhjet e karrierës sime?

☛ Kujdes – Konsideroni gjëra të tilla si zgjedhjet e ardhshme për shkollim

☛ Kujdes – Rendisni kërkesat kryesore.

Kush mund të më ndihmojë mua në arritjen e qëllimeve të mia? Listoni 3 persona që mund t'ju ndihmojnë të arrini qëllimet tuaja të të mësuarit.

☛ Kujdes – Mendoni në mënyrë strategjike. Përdorni për t'ju mbështetur familjen, miqtë, mësuesit dhe njerëzit që ju besoni.

Si mund t'ju ndihmojë shkolla të përgatiteni për përvojat e shkollimit dhe punësimit në të ardhmen?

Shembull	Mund të ndihmojë...	Kështu që unë...
----------------	---------------------	------------------

Këshillë: Zgjedhja e moduleve për arsimin professional në shkollë	Mësoni aftësi në një fushë që mund të më interesojë	Zbuloni nëse më pëlqen kjo punë apo jo

Plane për përvoja të punës sime në të ardhmen

Mendoni për punët që keni bërë në shkollë, në shtëpi, si dhe në komunitetin e jashtëm.	Më pëlqen	Nuk më pëlqen
Punë që bëj ose kam bërë në shtëpi		
Punë që bëj ose kam bërë në shkollë		
Punë që bëj ose kam bërë në komunitet		

Punë që nuk i kam provuar ende, por do të doja të mësoja më shumë rreth tyre	
--	--

Veprimtaria 4: Punojmë së bashku

Informacion

Bashkëpunimi

Në çdo kohë, njerëzit kanë punuar për të krijuar mekanizma për bashkëpunim dhe për zgjidhjen e konflikteve. Këto metoda përdoren në shumë sfera të jetës njerëzore dhe shoqërisë për të arritur qëllimet e një personi të veçantë ose një grupi njerëzish. Shpesh, janë aktivitetet e përbashkëta të organizatave, shteteve, ndërmarrjeve që sjellin një rezultat efektiv në një fushë apo në një tjetër.

Çfarë është bashkëpunimi? Bashkëpunimi është veprimtaria e disa palëve, përmes të cilave të gjithë pjesëmarrësit marrin një përfitim. Thelbi i bashkëpunimit konsiston në arritjen e qëllimeve të përbashkëta të partnerëve, pritjen e përfitimeve specifike nga ekzekutimi i marrëveshjeve dhe përfitimin reciprok. Këto tri pika janë thelbësore për çdo marrëveshje të sipërmarrjes së përbashkët.

Mësuesi përdor dy lloj bashkëpunimesh: në çift dhe në grup. Ai e ndan klasën në grupe për të planifikuar:

Në grup

- Aksion mjedisi
- Ekskursion
- Bërjen e një albumi
- Zhvillimin e një feste në klasë
- Organizimin e një loje

Në çift

- Zgjidhjen e një problemi matematik
- Bërjen e një kartoline
- Bërjen e një vizatimi ose aplikimi punë dore
- Gjetjen e një tregimi për fuqinë e bashkimit
- Bërjen e një loje dyshe (shah, karta, domino, etj.)

Fëmijët angazhohen në këto veprimtari për një periudhë kohe deri 10 minuta dhe më pas sipas grupeve në të cilat janë ndarë prezantojnë punët e tyre. Mësuesi i bën të gjithëve pyetjen:

- A mund të bëhet vetëm një aktivitet i tillë?



PROGRAMI ME MODULE PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE BAZË TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PROFESIONAL



VEPRIMTARI TË TJERA PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE BAZË

PROGRAMI ME MODULE
PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE
BAZË TË NXËNËSVE NË
ARSIMIN PROFESIONAL

ANEKS

Mësuesit për të krijuar një atmosferë të ngrohtë, argëtuese dhe miqësore mund të përdorin lojërat e mëposhtme për prezantimin e nxënësve me njëri –tjetrin. Këto Veprimtarie përdoren për t'i bërë të gjithë nxënësit të komunikojnë, të mësojnë më shumë për njëri-tjetrin dhe të respektojnë njëri-tjetrin. Disa nga këto metoda mësuesit mund ti përdorin dhe për trajtimin e temave të ndryshme.



Veprimtarie argëtuese për modulin 1

Hyrje e ngatërruar




Vendosini nxënësit në një rreth dhe filloni me raundin e parë të prezantimit. Të gjithë nxënësit duhet të thonë 3 gjëra: emri i plotë, ngjyra e preferuar dhe dëshirat për të ardhmen si në atë që dëshironi të jeni. Të gjitha përgjigjet duhet të jenë me një fjalë. Nxënësit vazhdojnë lojën në drejtim të akrepave të orës, secili thotë vetëm këto fjalë sipas rastit.

Bëni pak pushim dhe përsëri reformoni rrethin. Kërkojuni të gjithë nxënësve tani të tregojnë emrin e personit që qëndron djathtas tyre, ngjyrën e preferuar të personit dhe dëshirën e tyre. Kjo mund të bëhet më argëtuese me pyetje humoristike të drejtuara nga mësuesja.

Rrotulloni shishen

Kjo është një lojë e mbushur me argëtim. Organizojini fëmijët të qëndrojnë në një rreth dhe mësuesi rrotullon shishen. Kapaku i shishes tregon njërin fëmijë dhe baza e shishes tregon fëmijën tjetër. Fëmijës që i ka rënë baza e shishes mund t'i bëjë një pyetje fëmijës që i ka rënë kapaku. Ky i fundit duhet të përgjigjet për ndonjë pyetje personale ose ndonjë detyrë. Ai që përgjigjet saktë fiton dhe ka të drejtën të rrotullojë shishen. Kështu vazhdon me rradhë derisa përfundojnë pyetjet që mësuesi ose fëmijët kanë përgatitur.



Lojë me batanije

Ndani grupin në dy nëngrupe. Tani ngrini një batanije në mes. Pastaj çdo grup ka një person në këmbë dhe lëshon batanijen. Të dy duhet të thonë emrin e njeri - tjetrit. Ai që e thotë shkon në grupin fitues. Loja përfundon me një person të mbetur.

Rrethi i kujtesës

Qëndroni në një rreth dhe filloni me një person që flet emrin e tij. Pastaj personi pranë tij duke thënë emrin e personit të parë dhe duke shtuar emrin e tij më tej. Përsëri personi i tretë thotë emrin e të parës, pasuar nga emri i dytë dhe më pas emri i tij. Në të njëjtën mënyrë, vazhdoni të shtoni dhe t'i bëni fëmijët të kujtojnë emrin dhe serinë me të cilën mësuani emrat. Për më tepër, mund t'i shtoni emrin dhe kafshën ose frutat e preferuara, dhe të njëjtin rreth kujtese për të vazhduar.



Luaj “Unë kurrë nuk kam”

Krahasoni përvojat tuaja të jetës me të tjerët. Uluni në një rreth me anëtarët e tjerë të grupit. Shpërndajini 10 copa karamеле secilit lojtar. Më pas, ftoni secilin lojtar të ndajë një deklaratë "Unë kurrë nuk kam". Nëse ju e keni kryer Veprimtarian që personi ndau, jepini atij 1 nga karamelet tuaja. Vazhdoni rreth rrethit për aq kohë sa të dëshironi. Ju mund të thoni "Unë kurrë nuk jam pickuar nga një bletë", "Unë kurrë nuk kam parë oqeanin Paqësor", etj.



Veprimtarie argëtuese për modulin 2



Luaj “Dy të vërteta dhe një gënjeshtër”

“Dy të vërteta dhe një gënjeshtër” është një lojë e lehtë e cila mund të luhet me nxënësit e rinj dhe të vjetër. Ftojini çdo person në grupin tuaj të ndajë 2 fakte të vërteta për veten e tyre, si dhe 1 gënjeshtër. Pjesa tjetër e grupit do të përpiqet të hamendësojë se cilat fakte ishin të vërteta dhe cilat jo. Askush nuk duhet të ndajë ndonjë sekret apo rrëfim të madh - faktet e thjeshta për jetën tuaj janë një mënyrë argëtuese dhe edukative për të thyer akullin me bashkëmoshatarët tuaj.

P.sh. Deklaratat si: "Unë kurrë nuk kam ngrënë ushqim aziatik më parë", "Unë kam një gjarpër për kafshë shtëpiake" ose "Nuk jam larguar kurrë nga Shqipëria" janë fakte argëtuese që mund t'i ndani gjatë lojës. Kjo lojë e thjeshtë mund të çojë në biseda dhe zbulime interesante për njerëzit që mendonit se i njihni mirë.

Shkruani dy fakte dhe dy opinione

Mësuesi ndan dy letra me ngjyra (ngjy të rozë dhe jeshile) për çdo nxënës. Ai i kërkon secilit nxënës të shkruajë në letrën me ngjyrë jeshile dy fakte dhe në letrën me ngjyrë rozë dy opinione për shokun që ka ngjitur. Në flipchart ose në tabelë mësuesi vendos dy kollona në një rën anë “Opinione” (ngjyrë rozë) dhe në kollonën tjetër “Fakte” (ngjyrë jeshile), si në tabelën e mëposhtme. Më pas mësuesi i fton nxënësit ti ngjisin letrat në kollonën e saktë përkatëse. Ata diskutojnë dhe vlerësojnë së bashku saktësinë e tyre.



Fakte	Opinionë

Dallojmë faktin nga opinionin

- Merrni një top dhe shkruani në dy anët e tij fjalët "Fakt" dhe "Opinion" me një shënues të përhershëm. Nxënësit ia hedhin topin njëri-tjetrit. Kur një nxënës kap topin, ai ose ajo shikon se cila fjalë është poshtë ose më afër gishtit të madh të tij të djathtë. Nëse fjala është "Fakt" ai bën pohim për një fakt si p.sh.: Unë jam 14 vjeç dhe nëse fjala është "Opinion" ai jep një pohim për opinion si p.sh.: Ky është kampi më i mirë në Tiranë. Pastaj, ai ose ajo ia hedh topin dikujt tjetër. Ju mund ta bëni këtë një lojë eliminuese për përgjigjet e pasakta.
- Etiketoni një rën anë të dhomës "Fakt" dhe anën tjetër "Opinion". Secilit nxënës u jepet nga një kartë me një pohim të shkruar në të që mund të jetë një fakt ose një opinion. Nxënësit lexojnë kartën e tyre dhe shkojnë në këndin e duhur. Më pas nxënësve u jepet kohë të ndajnë kartat e tyre me njëri-tjetrin dhe të shohin nëse janë dakord me zgjedhjen që ka bërë shoku ose shoqja e tij më parë. Disa mund të kenë nevojë të ndryshojnë anët e dhomës. Rishpërndani letrat dhe luani përsëri.
- Lexoni ose shfaqni një nga një pohime me fakte dhe pohime me opinione. Nxënësit mbajnë kartat e indeksit me emërtimet "Fakt" ose "Opinion" mbi to për të treguar se çfarë lloj pohimi po bëhet. Ju gjithashtu mund të përdorni një kartë dhe të shkruani fjalët në secilën anë.

- ✚ Shkruani një pohim në tabelë dhe kërkojuni nxënësve të votojnë nëse është fakt apo opinion dhe më pas vendosini nxënësit të shpjegojnë arsyetimin e tyre.
- ✚ Lëri nxënësit të shkruajnë 10 fakte dhe 10 opinione për çdo gjë që mësuani sot ose lexuan sot si për shembull: turizëm, vende turistike, blerjet, modelimin, energjia elektrike, presidentët, etj. Diskutoni dhe vlerësoni saktësinë e përgjigjeve të tyre.
- ✚ Shkruani pohime që tregojnë opinione ose fakte në kartat e indeksit të koduara me dy ngjyra të ndryshme. Shpërndajini ato te nxënësit dhe vendosini nxënësit të ecin nëpër dhomë duke ndarë me njëri-tjetrit atë që është në kartat e tyre. Më pas, nxënësit të ndahen në grupe sipas ngjyrës së letrave të tyre dhe të shpjegojnë pse janë në këto dy grupe.
- ✚ Ndajeni klasën në katër grupe, jepuni secilit grup një flipchart dhe kërkojini çdo grupi të shkruajë në flipchartin e tij në mënyrë rastësore 4 pohime: 2 fakte dhe 2 opinione pa i cituar se çfarë janë ato. Më pas grupet lëvizin nga tavolinë në tavolinë duke shkruar "F" për faktin ose "O" për opinionin. Pasi kanë lëvizuar në të gjitha tavolinat lexojnë, diskutojnë dhe vlerësojnë gjetjet e njëri-tjetrit. Kontrolloni përgjigjet duke kërkuar nga studentët që kanë shkruar secilën deklaratë të thonë se çfarë lloj deklarate është.

Fakt, opinion apo këndvështrim?

Mësuesi e ndan klasën në tre grupe dhe prezanton pyetjet e mëposhtme. Secili grup lexon me kujdes pyetjet.

Shembuj pyetjesh

1. Ku dhe kur keni lindur?
2. A e hani mishin? A e keni mbaruar klasën e nëntë?
3. A mendoni se Shqipëria është një vend i mirë për të jetuar?
4. Çfarë lloj muzike ju pëlqen?
5. A mbani celularë gjatë mësimit dhe në pikëpamjen tuaj a duhet të mbajnë fëmijët celular gjatë orës së mësimit?
6. A kanë nevojë fëmijët për detyra shtëpie?

Grupi 1. Mësuesi i kërkon nxënësve të tregojnë dhe argumentojnë se cilat pyetje gjenerojnë përgjigje të padiskutueshme. Tregoni përgjigjet e tyre? (pyetja 1;2)

Grupi 2. Mësuesi i kërkon nxënësve të tregojnë dhe argumentojnë se cilat pyetje gjenerojnë përgjigje që tregojnë preferencën apo qëndrimin e një personi? (pyetja 3;4)

Grupi 3. Mësuesi i kërkon nxënësve të tregojnë dhe argumentojnë se cilat pyetje gjenerojnë përgjigje që shpjegojnë pikëpamjen/këndvështrimin e dikujt për një temë? (5;6)



Veprimtarie argëtuese për modulin 3



Luaj “Këpuca akullthyesë”

Mësoni për pjesën tjetër të grupit tuaj përmes këpucëve të tyre. Të gjithë nxënësit të qëndrojnë në një rreth dhe të heqin këpucët. Më pas, ftoni 1 person të marrë një palë këpucë të rastësishme dhe të bëjë një supozim pozitiv për personin e cila i përket ajo këpucë. Personi të cilës i përket këpuca më pas do të prezantohet dhe do të vazhdojë lojën duke rrëmbyer një palë këpucë të tjera.

Ju mund të thoni, "Personi i këtyre këpucëve ka një ndjenjë të shkëlqyer të modës" ose "Personi që zotëron këto këpucë nuk duhet të pëlqejë të jetë i ftohtë".

Cilësitë e mia

Mësuesi fton nxënësit të tregojnë dy cilësi që ata kanë. Në tabelën më poshtë është dhënë një listë e cilësive të cilët njerëzit e përdorin kur përshkruajnë vetveten (*i qetë, gazmor, i mençur, i sjellshëm, logjik, etj.*). Nxënësit diskutojnë rreth këtyre cilësive, kush cilësi i përfaqëson më mirë ata dhe pse (*sjellin shembuj nga jeta e përditshme e tyre*). Nëse keni ndonjë “cilësi” që nuk e gjeni në listë shkruajeni në rreshtat bosh.

Tabela

Cilësitë e mia:	Shëno ✓
I/e qetë	
Takoj shumë njerëz	
Kryesisht punoj vetëm	
Artistike	
I kujdesshëm/e kujdesshme	
I/e organizuar	
I besueshëm/e besueshme	
I shoqërueshëm/e shoqërueshme	
Gazmor	
I durueshëm/e durueshme	

Gjakftohhtë	
Energjik	
Serioz	
I sjellshëm/e sjellshme	
I/e mençur	
I/e aftë	
Vetëbesues	
Vërej detajet	
I ndryshëm/e ndryshme	
I turpshëm/e turpshme	
I/e qetë gjatë zgjidhjes së problemeve	
Logjik/e – arsyetoj në mënyrë logjike	
Impulsiv/e – reagoj para se të mendoj	
I ndjeshëm/e ndjeshme	
Kategorik/e – i/e prerë në vendime	
Tërheqës/e	
Trim/e	
I/e vendosur	
I/e singertë	
Humorist/e	
Njeri i dashur	

Kodoj aftësitë e mia

Një aftësi është diçka që ju e bëni mirë, të tilla si futbolli, kërcimi, gatimi, leximi ose të folurit në publik etj. Ne të gjithë kemi aftësi dhe është e rëndësishme që të njohim aftësitë që kemi dhe aftësitë që duhet të zhvillojmë. Nxënësit plotësojnë individualisht fletën e punës “Kodoj aftësitë e mia”. Duke përdorur fletën e punës "Kodoj aftësitë e mia" nxënësit renditin dhjetë aftësitë që aktualisht i konsiderojnë më të dobishmet në botën e punës.



1. Lexoni listën e aftësive në tabelë. Ju ndoshta do të keni disa nga këto aftësi tashmë. Lexojini ato me kujdes duke përdorur shembujt për t'ju ndihmuar t'i kuptoni ato.
2. Zhvilloni një çelës për ta, duke përdorur katër ngjyra ose modele të ndryshme për kategoritë, për shembull:



E kuqe: shumë mire



Blu: mund të bëjë



E gjelbër: do të doja të zhvillohej



Gri: nuk vlen për mua.

3. Tani kodoni listën e aftësive në tabelën bosh, sipas çelësit më lart.
4. Ju mund të dëshironi të shtoni disa aftësi që nuk janë tashmë në tabelë.

Aftësi	Shembull	Kodi
Puna në grup	Ndihmoni një nxënës të ri që të ambientohet në klasën tuaj	
Puna me numrat	Kursimi i parave të xhepit	
Kreativ	Shkrimi i tregimeve, përdorimi i grafikës kompjuterike, piktura, fotografi, etj.	
Qëndrojnë në formë të mirë fizike	Të praktikosh dhe të merresh me sport rregullisht	
Komunikimi - dëgjimi	Me miqtë, mësuesit etj. siguroheni që ju t'i transmetoni mesazhet me saktësi	

Aftësi kompjuterike	Përdorimi i një video kamerë, përdorimi i një kompjuteri.	
Planifikimi dhe organizimi	Organizimi i diskos së shkollës ose organizimi i një projekti/ konkursi në shkollë.	
Kërkimi	Gjetja e informacionit për një detyrë shkollë	
Zgjidhja e problemeve	Të përpunosh se si të arrish në një vend, të zgjidhësh fjalëkryq	
Projektimi i gjërave të reja	Punime dore, teknikë, veshje.	
Të mësosh aftësi të reja	Hapa të rinj kërcimi, lëndë, aftësi sportive	
Montimi ose riparimi i gjërave	Riparimi i shpimeve në gomat e biçikletave, montimi i kompleteve	
Menaxhimi	Menaxhimi i kohës suaj, parave, shokëve në një ekip.	
Ndjekja e udhëzimeve	Përgatitja e një vakti, sipas një recete	
Tregoj iniciativë	Të vazhdosh me gjërat pa pasur nevojë të t'i kërkojnë	

Pasi fëmijët plotësojnë tabelën ata diskutojnë me njëri-tjetrin mbi aftësitë e tyre duke i evidentuar këto aftësi si pikat e tyre të forta.



Veprimtarie argëtuese për modulin 4

Luajmë me karta e qytetit “Headbenz”



Paraprakisht, shënoni emrat e qyteteve turistike në një grup kartash indeksi.

Mblidhni grupin tuaj dhe kërkonit katër fëmijë vullnetarë të ulen në karrige përballë gjithë fëmijëve të tjerëve.

Bashkëngjitni një kartë tregues në ballin e çdo fëmije vullnetar, duke u siguruar që individi në fjalë të mos shohë atë që shkruhet në kartë.

Objektivi i secilit fëmijë vullnetar është të identifikojë emrin e qytetit turistik të shkruar në kartën e tyre duke i bërë audiencës sa më pak pyetje 'Po/Jo' të jetë e mundur.

Çdo pjesëmarrës mund t'i bëjë audiencës një pyetje "Po" ose "Jo" në të njëjtën kohë.

Pjesëmarrësit vazhdojnë të bëjnë pyetje derisa të kenë identifikuar saktë qytetin turistik.

Fiton pjesëmarrësi i parë që identifikon saktë emrin e qytetit turistik. Vazhdoni derisa të gjithë të gjejnë se cili qytet gjendet në kartën e tyre.

Të punojmë me hartën

Nxënësit gjejnë në internet fotot të qyteteve turistike në Shqipëri. Ata i grumbullojnë, i presin dhe i vendosin ato në hartën e Shqipërisë.

Harta e Shqipërisë



Harta e Shqipërisë duke u plotësuar me qytetet e zgjedhur



Pyetje të çuditshme për të thyer akullin

- Cili është një ushqim i çuditshëm që keni provuar? A do ta haje sërish?
- Na tregoni sfondin (çallpaper) e telefonit tuaj celular. A ka ndonjë histori pse e keni zgjedhur?

- Nëse do të mund të kishit diçka pa kufi (p.sh. ushqim, udhëtim, veshje, dashuri) për pjesën tjetër të jetës tuaj, çfarë do të zgjidhnit?
- A do t'i lejonit alienët t'ju drejtonin nëse do të vinin në Tokë?
- Në çfarë stine do të dëshironi të ishit?
- Cila është një lëvizje e thjeshtë kërcimi që doni ta përmirësoni?
- Cila është kënga juaj e preferuar për të kënduar? Këndojeni atë.
- Nëse do të mund të ishit ndonjë krijesë e mbinatyrshme, cilën do të zgjidhnit?
- Në cilin reality shoëdo të dëshironit të ishit protagonist?
- Ka një anije vajtje-ardhje falas për në Mars. Do të duhet një vit nga jeta juaj për të shkuar, vizituar dhe për t'u kthyer. Do të shkoni, argumentoni qëndrimin tuaj?
- Imagjinoni që mund të gjendeni kudo. Ku do të shkonit tani?
- A do të dëshironit që një person t'ju ndjekë kudo dhe të bëjë atë që keni kërkuar prej tij?
- Zgjidhni ndonjë grup muzikor që do të dëshironit të luajë në martesën tuaj.



Veprimtarie argëtuese për modulin 5

Diskutoni në klasë

- Cilat janë vlerat e punës në grupe?
- Cilat janë disa nga përvojat e tyre nga bashkëpunimet në nivel klase, shkolle, lagje apo Nxënësit tregoni se ç'ndjenja provojnë kur mësojnë dhe punoni me shokët dhe shoqet e tyre.

Mikrofoni magjik

Klasa vendos për një objekt, që do të shërbejë si mikrofoni për shembull për një lapustilë ose një mikrofoni lodër. Arrihet në marrëveshjen që vetëm personi që do të mbajë mikrofoni magjik mund të flasë, ndërsa gjithë të tjerët do të shohin dhe do të dëgjojnë folësin. Folësi thotë një ose dy fjali. Më pas ia kalon mikrofoni shokut që është pas tij. Ndonjë fëmijë që nuk dëshiron të flasë, e kalon mikrofoni tek tjetri.

Tematika e diskutimit është tregimi i përvojës së secilit nxënës për punën e përbashkët. Shembuj:

Unë mësoj me shokun time Aiden.....Unë punoj me gjyshin tim në kopshtin e shtëpisë.....Unë pastroj mjedisin me shokët e lagjes.....

Loja e mikrofoni magjik ka si qëllim të saj zhvillimin e kulturës së dëgjimit të tjetrit dhe

respektimin e fjalës së tij. Ajo mund të përdoret në më shumë se një tematikë. Për shembull: Kur punoj me të tjerët dhe kam konflikte: Unë nuk shaj.....Unë nuk gjuaj....., etj.

Mbillni pemë në komunitetin

Një kopsht i përbashkët mund të jetë një projekt argëtues për nxënësit sidomos për atë cilët janë të apasionuar pas kopshtarisë. Kjo ide vullnetare është një mënyrë e shkëlqyer për t'u lidhur me banorët e komunitetit rreth shkollës suaj.

Si fillim, do t'ju duhet të zgjidhni një vendndodhje për kopshtin tuaj, ta pastroni atë, të krijoni një dizajn, të siguronit materiale si farat dhe dheun dhe të organizoni punën me ekipe pune vullnetare. Më pas, mund të zgjidhni një parcelë për bimët, lulet ose perimet tuaja dhe të filloni mbjdhjen. Në fund, komuniteti juaj do të ketë një burim të ri pasurimi afatgjatë.

Kopshtet e komunitetit janë gjithashtu një nga aktivitetet më të mira vullnetare në grup për nxënësit.



Veprimtarie argëtuese për modulin 6

Zbuloj zotësitë dhe interesat e mi

Ju të gjithë i evidentoni disa zotësi/ aftësi në të cilat jeni të mirë. Kur je i zoti në diçka, zakonisht do të thotë që fiton kënaqësi duke e bërë atë. Ju mund t'i zhvilloni më tej këto zotësi dhe t'i zbatoni ato në punën tuaj ose aktivitetet e kohës së lirë.

Zotësitë/aftësitë e mia

Plotësoni tabelën e mëposhtme duke vendosur shenjën √ në kutitë përkatëse për të treguar se sa mirë i bëni këto gjëra.

Aktiviteti	Më shumë	Më pëlqen	Nuk më pëlqen
Planifikimi i aktiviteteve sociale			
Të luaj sport			
Kopshtaria			
Shkrimi i tregimeve ose poezive			
Të zë shokë			
Puna me makineri dhe pajisje			

Të kujtoj gjëra			
Matematika			
Të luaj një instrument muzikor			
Të marr përgjegjësi			
Të mësojë diçka të re interesante			
Të bisedoj me njerëzit			
Të jem udhëheqës i ekipit			
Të gatuaj			
Të dëgjoj të tjerët			
Të punoj si pjesë e një ekipi			
Të ndjek udhëzimet			
Shëtitjet			
Të jem miqësor			
Të flas para njerëzve			
Të punoj pa mbikëqyrje			
Të projektoj gjëra			
Vizatimi, piktura ose qeramika			
Ngritja e objekteve të rënda			
Të kujdesem për kafshët			
Lojërat kompjuterike			
Fotografia			
Të jem në formë dhe i/e shëndetshme			
Shitja e gjërave			
Sinqeriteti			
Promovimi i aktiviteteve dhe ngjarjeve			

Interesat e mia

Megjithatë disa gjëra kënaqeni duke i bërë dhe disa gjëra të tjera që nuk ju pëlqejnë.

Plotësoni tabelën e mëposhtme duke vendosur shenjën √ në kutitë përkatëse për të treguar se sa shumë ju pëlqen t'i bëni këto gjëra.

Aktiviteti	Më pëlqen shumë	Më pëlqen	Nuk më pëlqen
------------	-----------------	-----------	---------------

Planifikimi i aktiviteteve sociale			
Të luaj sport			
Kopshtaria			
Shkrimi i tregimeve ose poezive			
Të zë shokë			
Puna me makineri dhe pajisje			
Të kujtoj gjëra			
Matematika			
Të luaj një instrument muzikor			
Të marr përgjegjësi			
Të mësojë diçka të re interesante			
Të bisedoj me njerëzit			
Të jem udhëheqës i ekipit			
Të gatuj			
Të dëgjoj të tjerët			
Të punoj si pjesë e një ekipi			
Të ndjek udhëzimet			
Shëtitjet			
Të jem miqësor			
Të flas para njerëzve			
Të punoj pa mbikëqyrje			
Të projektoj gjëra			
Vizatimi, piktura ose qeramika			
Ngritja e objekteve të rënda			
Të kujdesem për kafshët			
Lojërat kompjuterike			
Fotografia			
Të jem në formë dhe i/e shëndetshme			
Shitja e gjërave			
Sinqeriteti			
Promovimi i aktiviteteve dhe ngjarjeve			

Përgjigjuni më poshtë dhe diskutoni në klasë përgjigjet tuaja.

1. Gjëra të tjera që më pëlqen të bëj janë:

2. Disa gjëra që nuk më pëlqejnë të bëj janë:

3. Ndonjëherë njerëzit duhet të bëjnë gjëra që nuk u pëlqejnë. Rendisni disa nga gjërat që nuk ju pëlqen të bëni, por duhet t'i bëni.

4. Krahasoni informacionin për interesat tuaja me informacionin e zotësive aftësive tuaja dhe plotësoni tabelën.

Gjërat që jam i mirë dhe më pëlqejnë	Gjërat që jam i mirë dhe nuk më pëlqejnë

5. Identifikoni disa punë dhe aktivitete të kohës së lirë ku mund të jeni në gjendje të bëni gjëra në të cilat jeni të mirë dhe të pëlqejnë.

Gjërat që jam i mirë dhe më pëlqejnë	Punë ku mund t'i bëja këto gjëra	Aktivitetet e kohës së lirë ku mund t'i bëja këto gjëra

Veprimtari

Diskutoni fletën e punës më poshtë “**Përdorimi i ujit**”

Mësuesi diskuton me nxënësit:

- Si e shpenzoni ujin në shtëpi?
- A e kurseni ujin në shtëpi?
- Diskutoni rreth mundësisë të kursimit të ujit kur i lajmë dhëmbët. *(Ai që lan dhëmbët duhet ta hapë çezmën e ujit vetëm kur duhet të lagë furçën ose dhëmbët, ndërsa e mbyll gjatë kohës kur i pastron dhëmbët me furçë.)*

Tregojuni nxënësve se përshtypja e parë është se kjo mënyrë e kursimit nuk ka efekt të rëndësishëm gjatë kursimit të ujit. Mes të tjerash, në realitet, nëse secili e bën këtë ndryshim të vogël mund të ketë një efekt shumë të madh.

Higjiena personale



Pastrimi




- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> ✓ Mos e lini ujin që të rrjedhë derisa të lani dhëmbët, duart apo fytyrën. ✓ Mendoni se a është më mirë të: bëni një banjë (me 100 - 200 litra) apo një dush (me rreth 80 litra). ✓ Mos hidhni mbetjet në tualet. | <ul style="list-style-type: none"> ✓ Para se t'i lani enët, pastroni mbetjet e ushqimeve nga pjatat. ✓ Mos i lani enët e palara nën ujin që rrjedh, por në vend të kësaj, mbusheni lavamanin me ujë. Kjo mënyrë kursen gjysmën e sasisë së ujit që do t'iu nevojitet. ✓ Vendoseni lavatriçen vetëm kur ajo |
|---|---|

		është e mbushur plot me rroba që duhen larë. ✓ Lani makinën tuaj duke përdorur ujin e një kove dhe vetëm në fund përdorni për shpëlarje tubin me ujë të rrjedhshëm. ✓ Pastroni ballkonet me ujë shiu. Përdorni fshesën për t'i larë gjethet që kanë rënë dhe jo zorrën e ujit.	
Gatimi/pija		Ujitja	
✓ Vendosni mbyllës në lavaman kur i pastroni frutat dhe perimet. ✓ Mos i ftohni ushqimet ose pijet me ujin që rrjedh nga çezma. ✓ Nëse dëshironi ujë më të ftohtë, atëherë mos prisni që të ftohet uji duke rrjedhur nga çezma, por mbani shishe me ujë të ftohtë në frigorifer.		✓ Mos e përdorni ujin e pijshëm për vadtjen e kopshtit - përdorni ujë prej burimeve ose shirave të mbledhura më herët. ✓ Evitoni vadtjen e kopshtit kur koha është me erë ose shumë e nxehtë sepse atëherë uji avullon më shpejt. ✓ Përdorni vadtje me spërkatës, me anë të të cilit kursehet një sasi e madhe uji. ✓ Mbuloni vendet e vadtura me kashtë ose gjethe që ta kufizoni avullimin.	


Veprimtaria 6: Mësojmë të vizatojmë

Duke ndjekur udhëzimet në secilën foto mësimdhënësi u kërkon nxënësve të zhvillojnë vizatimin e mëposhtën:

Vizatoni një peizazh buzë liqenit



1. Vizatoni pesë vija këndore.




2. Shtoni liqenin, pemën dhe mullirin me erë



3. Shtoni pemë sipër liqenit.



4. Vizatoni retë mbi pemë.



5. Shtoni shtëpinë, pemën, makinën



6. Vizatoni ndërtesat më poshtë.



7. Shtoni dritare dhe dyer.



8. Vizatoni majat e mëdha të pemëve.



9. Ngjyroseni

Imagjinoj personazhin kryesor

Mësuesi u thotë nxënësve: Imagjinoni një personazh që ju pëlqen shumë si një fëmijë, si një i rritur dhe si një i moshuar. Tregoni ose shkruani se çfarë se mund të bëjnë në këtë moment të jetës së tyre dhe shpjegoni pse mund ta bëjnë këtë. P.sh., mund të luajnë, të shikojnë një film, ushqyhet me ushqime të shijshme.

Fotografia e emocioneve

Duke përdorur një iPad ose një aparat fotografik digjital, imitoni fytyrën e personazhit të preferuar gjatë fragmentit, si p.sh., emocionet e tij kur sheh një person që do, kur ha ushqimin e preferuar, etj., dhe bëni disa fotografi.

Vendosini ato së bashku në një dokument në kompjuter dhe shpjegoni emocionin poshtë figurës dhe kur personazhi që ju zgjodhët do të ishte ndjerë në këtë mënyrë.



Ditari dy pjesësh

Nxënësve iu jepet një pjesë e tekstit dhe në kolonën tjetër, shkruajnë se si e kuptojnë atë.

Një pjesë nga teksti	Si e kuptoj unë?

Veprimtari matematikore

Një këshill bashkiak e ndau buxhetin si më poshtë: 45% për shërbime publike; 25% për mirëmbajtje rrugësh; 10% për transport; 10% për përmirësim të kanalizimeve të ujërave të zeza; 5% për zbukurim të hapësirave publike; 5% për investime.

Si mendoni ju për ndarjen?

Ju do të kishit bërë një ndarje tjetër? Kujt do t'i jepnit më shumë rëndësi?

Paraqitni këto të dhëna me anë të një diagrami rrethor.

Në qoftë se për zbukurimin e hapësirave publike u shpenzuan 30 000 lekë, sa është buxheti gjithsej që kishte bashkia?

Kostoja gjatë një udhëtimi

“Ju sapo jeni kthyer nga një udhëtimi njëditor me prindërit. Mamaja juaj kontrollon në portofolin e saj dhe pa se kishin tepruar dy kartmonedha 1000 lekëshe, një kartmonedhë 500 lekëshe, një kartmonedhë 200 lekëshe, tri monedha 50 lekëshe, një monedhë 20 lekëshe, një monedhë 10 lekëshe dhe 3 monedha 5 lekëshe. Ajo mbante mend se familja kishte shpenzuar dy herë para, gjatë udhëtimit. Ajo shpenzoi 1150 lekë në një market dhe disa para për ushqim. Kur ajo numëroi sasinë e parave në portofol, ajo kuptoi se kishte ekzaktësisht gjysmën e sasisë së lekëve që kishte në mëngjes. Llogarisni sa lekë shpenzoi familja juaj për ushqim gjatë udhëtimit? Llogarisni sa lekë kishte familja në fillim të udhëtimit?

Ju i thatë mamit se donit të blinit një top i cili kushtonte rreth 3000 lekë.

Diskutoni çfarë ju tha mamaja.

Shprehni në formën e buxhetit dhe shpenzimeve të gjitha të dhënat.

Klasa ndahet në grupe me nga 4 persona. Në një fletë të madhe punohet me planifikimin e një buxheti. Si do ta shpenzonit ju këtë sasi parash

Grupi 1 10000 lekë

Grupi 2 15000 lekë

Grupi 3 20000 lekë

Grupi 4 25000 lekë

Po sikur t’ju duhet të planifikoni buxhetin për tre vitet e ardhshme me të njëjtën sasi parash si do ta planifikonit buxhetin?

Prezantoni punën tuaj në secilin rast.

Shpenzime familjare

Shpenzimet totale të një familjeje prej katër anëtarësh gjatë gjashtë muajve të parë të vitit për ushqim ishin përkatësisht 45 645 lekë, 52 532 lekë, 47 584 lekë, 37 595 lekë, 52 022 lekë dhe 47 289 lekë.

Si mendoni sa ka shpenzuar mesatarisht për ushqimin kjo familje? Krahasoni rezultatin me njëri – tjetrin.

Për ushqim gjatë vitit 1990, prindërit i thanë Andit se ata kanë shpenzuar 4756,52 lekë. Si mendoni sa ka shpenzuar mesatarisht për ushqimin kjo familje?
Krahasoni mesataren sot dhe atë të vitit 1990

Fermerët e djathit

Gjatë javës së 5 marsit, shtatë fermerë dorëzuan në një fabrikë djathi sasitë e mëposhtme të qumështit: 680 litra, 425 litra, 650 litra, 580 litra, 680 litra, 600 litra dhe 900 litra.

Sa ishte sasia mesatare e dorëzuar nga secili prej shtatë burrave? Po moda, Po mesorja?

Diskutoni rezultatet me shokët

Sa vezë ke?

Një herë e një kohë jetonte një zonjë e moshuar dhe vendosi të zbriste në qytet për të shitur vezë në një supermarket ose dyqan me shumicë. Kur e pyetën sa ke, plaka tha:

- Unë nuk di të numëroj më shumë se 100 po ama di që: Nëse i paketoj vezët me nga 2, ose me nga 3, ose me nga 4, ose me nga 5, ose me nga 6, ose me nga 7, ose me nga 8, ose me nga 9, ose me nga 10 kokrra, gjithmonë mbetet një vezë. Por nëse i paketoj vezët me nga 11 kokrra nuk mbetet asnjë vezë.

Sa vezë kishte zonja e moshuar. Provoni dhe ju. Si ju del?

Kostot e ushqimit

Për të përgatitur turli për drekë, për 4 persona, mamaja (ose babai) do të përdori 200 gr qepë, 300 gram patate, 200 gram patëllxhanë, 250 gram kunguj, 150 gram karrota, 100 gram domate dhe 100 ml vaj ulliri.

- a) Nëse ai/ajo do të përgatisë gjellë për 15 persona dhe ju kërkon ju të llogarisni sa gr duhet të hedhë për çdo përbërës, si do ta ndihmoni ju?
- b) Nëse 1 kg qepë kushton 60 lekë, 1kg patate kushton 70 lekë, 1 kg patëllxhanë kushton 120 lekë, 1 kg kunguj kushton 80 lekë, 1 kg karrota kushton 90 lekë, 1 kg domate kushton 100 lekë dhe 1 litër vaj ulliri kushton 600 lekë, si do ta ndihmoni mamin (babin) për koston e racionit për një person.

Lojë me numrat e plotë

Në një letër vizatojmë tabelën e lojës siç tregohet në figurë.

	-10	-9	-8	-7	-6	-5	-4	-3	-2	-1	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	

Përgatisim dy zare kubikë me 6 numra. Njëri zar ka numrat pozitivë 1,2,3,4,5,6 ndërsa zari tjetër ka numrat -1;-2;-3;-4;-5; -6

Rregullat e lojës:

- Loja luhet me dy lojtarë, lojtari A (numrat negativë) dhe lojtari B (numrat pozitivë).
- Loja fillon në 0.
- Hidhen të dy zaret njëkohësisht për të parë se kush e fillon lojën i pari. Personi që grumbullon më shumë pikë nga zaret fillon lojën i pari. Psh. Lojtari A ka 5 dhe -3, ndërsa lojtari B ka 4 dhe -1. Atëherë lojtari B fillon lojën i pari.
- Loja luhet me radhë nga secili lojtar duke hedhur të dyja zaret.
- Secili lojtar lëviz në tabelë sipas pikëve të grumbulluara gjatë hedhjes së zareve në rradhën e tij. Psh. $-3 + 2 = -1$ lojtari lëviz një kuti majtas (negative). $3 + -1$ lojtari lëviz 2 kuti djathtas.
- Lojën e fiton kush mbërrin i pari te 10 ose -10.